

Raporti Vjetor i RrGGK 2013

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2014

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, derisa autorët citohen. Ky publikim është relizuar me mbështetjen e Kvinna till Kvinna. Qëndrimet në këtë publikim janë qëndrime të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës dhe nuk paraqesin në asnjë mënyrë mendimet e Kvinna till Kvinna.

www.womensnetwork.org

Printuar nga Night Design në Prishtinë, Kosovë



Kvinna till Kvinna



Raporti Vjetor i RrGGK 2013



PËRMBAJTJA

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RRGKK.....	4
HYRJE.....	6
Vizioni i RrGGK.....	6
Misioni i RrGGK.....	6
Strategjia e RrGGK.....	6
Rreth Raportit Vjetor të RrGGK.....	7
NGRITJA E KAPACITETEVE TË RRGKK.....	8
Anëtarët e RrGGK të informuara për iniciativat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGGK, mundësive të financimit dhe informata tjera.....	8
RrGGK përkrah funksionimin e organizatave e grave serbe në Kosovë.....	11
Anëtarët e RrGGK dhe dukshmëria e punës së tyre.....	12
Anëtarët e RrGGK aftësohen për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive dhe për të ndërmarr iniciativa më efektive avokuese.....	12
Përfshirja e Aktivisteve të reja në RrGGK.....	25
Gratë e Rajonit Rrisin Bashkëpunimin.....	28
Gratë Kosovare mbështesin krijimin e Gjykatës së Grave.....	29
RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIM-MARRJE.....	30
Gratë në politikë, OJQ-të e grave dhe gratë votuese komunikojnë dhe bashkëpunojnë me shumë rreth çështjeve që gratë i konsiderojnë si prioritare.....	30
Me shumë gra të zgjedhura dhe të emëruara në nivel komunal dhe qendror.....	34
Gratë më aktive në proceset e vendim-marrjes lidhur me paqen dhe sigurinë.....	35
Politikat publike të ndryshuara për të pasqyruar prioritetet e grave votuese.....	38



PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDES CILËSOR SHËNDETËSOR.....	39
Më shumë gra dhe vajza të vetëdijshme për të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor.....	39
Më shumë gra të vetëdijësuar se si të zbulojnë shenjat e kancerit.....	40
JETA PA DHUNË NË FAMILJE DHE PA TRAFIKIM	42
Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me legjislacionin, përfshirë edhe burrat.....	42
Fuqizohet grupi punues brenda RrGGK-së	44
Shumë Gra Zhvillojnë dhe Menaxhojnë Biznese të suksesshme	45
Shumë vajza ndjekin nivelet më të larta të arsimit.....	46
INICIATIVA TË RËNDËSISHME.....	47
Historitë Gojore	47
Mbulimi mediatik dhe Aktivitetet në Internet	48
VLERËSIMI I PUNËS SË RRGK	50
RAPORTI FINACIAR I RRGK-SË PËR VITIN 2013	51
GRANTET E FONDIT TË GRAVE TË KOSOVËS.....	58
Donacione tjera për anëtarët e RrGGK.....	60
PËR NE	61
Bordi i Drejtorëve të RrGGK	61
Bordi Këshillëdhënës i RrGGK.....	61
Anëtarët e Stafit të RrGGK për vitin 2013.....	61
Personat që kanë punuar vullnetarisht për RrGGK.....	62
ANËTARET E RRGK.....	63
Anëtarët Individual të RrGGK-së.....	68

LETRA E KRYETARES SË BORDIT TË RRGKK

Të nderuara anëtare të Rrjetit,

Kam kënaqësinë dhe privilegjin të ju drejtohem me këtë letër në përfundimin e një viti tjetër të suksesshëm për Rrjetin. Që nga përzgjedhja ime si kryetare e bordit, nuk kalon ditë që nuk vazhdoj të mrekullohem nga fuqia, pasioni dhe dinamika e punës që e përcjell Rrjetin çdo ditë. Prej stafit të rrjetit i cili është shumë i motivuar dhe i dedikuar për përmbushjen e misionit të Rrjetit deri te secila organizatë anëtare që ofron çdo ditë tërë qenien e vet dhe angazhimin maksimal për të arritur qëllimet e përbashkëta.

Dhe çfarë misioni kemi në fakt, që nga përkrahja dhe kërkimi jonë dita ditës që ta bëjmë Kosovën shtet të mundësive të barabarta dhe të përgjegjshëm për gjithë qytetarët e vet por më tepër ta ndihmojmë shoqërinë të zhvillohet dhe rritet me besimin se çdo person duhet t'i ketë mundësitë e barabarta për të vendosur për jetën e vet. Rrjeti çdo ditë ka punuar aktivisht nga avokimi, hulumtimi por edhe përkrahja me grante të vogla për të realizuar qëllimet e veta si në: përkrahjen e grave mbijetuese të formave të ndryshme të dhunës; adresimin e pabarazive të ngulitura thellë në shoqërinë tonë; përkrahjen e familjes në nevojë për të rritur fëmijët në një ambient të sigurt deri te përkrahja e grave që të kenë mundësinë për të zgjedhur dhe të jenë ekonomikisht të pavarura.



Për më tepër duke e ngritur vetëdijën shoqërore që secili individ të ketë mundësi të zgjedh për jetën e vet ne vazhdojmë të tregojmë se secila jetë e jona ka rëndësi dhe duhet të jetë në fokus të zhvillimit në Kosovë.

Kosova sot po kalon një zhvillim, për fat të keq, të fokusuar vetëm në prioritetet mashkullore duke ma rikujtuar një thënie të një aktivisteje të Gjakovës: "...Do të ecja edhe nëpër lloq vetëm e vetëm ta dija se kur kthehem në shtëpi e kam një kulm të sigurtë mbi kokë dhe fëmija im do të ketë ushqim dhe shkollim të mirëfilltë." Kjo thënie na përkujton se për një zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë duhet të ketë sakrifica mirëpo jo duke sakrifikuar edhe terësisht mundësitë për një rritje stabile dhe të qëndrueshme për fëmijët tanë.

Nevojat e interesat të çdo gruaje duhet ti marrim parasysh sepse siç na rikujton feminizmi çdo përvojë personale është e rëndësishme dhe politike. E gratë janë ato që dijnë, dojnë dhe munden të iu përkujtojnë çdo ditë grave tjera dhe burrave që i përfaqësojnë të mos i harrojnë këto qëllime duke kërkuar një zhvillim të bazuar në nevojat dhe interesat e secilit prej nesh.

Fuqia jonë qëndron në qëllimet tona të sinqerta që kanë bërë bashkë aq shumë gra dhe burra të ndryshëm të solidarizohen për realizimin e këtyre qëllimeve. Rrëfimet e shumta që po realizojmë dhe shohim çdo ditë e tregojnë fuqinë e Rrjetit për të përfaqësuar gratë nga komunitetet e ndryshme dhe me përvoja aq diverse. Sukseset janë të shumta por mbesim të dedikuar që të reflektojmë më shumë dhe të mos ta ndalim hapin në kërkimet tona.

Duke ju dëshiruar një vit të suksesshëm përpara edhe njëherë ju përgëzoj për arritjet e deritanishme.

Ariana Qosaj-Mustafa



HYRJE

Vizioni i RrGGK

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) parasheh që në shtetin e Kosovës gratë dhe burrat të jenë të barabartë dhe të kanë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje në politikë, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni i RrGGK

Misioni ynë është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimimit, orientimin seksual dhe aftësitë. RrGGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe të shërbimeve.

Strategjia e RrGGK

Për të përmbushur këtë mision, RrGGK ka hartuar Planin Strategjik për periudhën 2011-2014. Qëllimi i kësaj strategjie është që të drejtojë punën e RrGGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, bordi i drejtorëve, partnerët dhe palët tjera relevante. Kjo strategji e RrGGK-së është e ndarë në pesë fusha programatike: I) Ngritja e kapaciteteve të RrGGK; II) Gratë në politikë dhe vendim-marrje; III) Shëndeti i grave; IV) Dhuna në familje dhe trafikimi; dhe V) Fuqizimi ekonomik i grave. Anëtares tona kanë identifikuar këto si fushat kryesore në të cilat RrGGK duhet të fokusohet më shumë.



Rreth Raportit Vjetor të RrGGK

Çdo vit rrjeti raporton te anëtares e veta, te partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Raporti përmban informata lidhur me aktivitetet e RrGGK nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2013. Ky raport është i ndarë në pesë pjesë në të cilat përfshihen objektivat afatgjata të rrjetit:

- Ngritja e kapaciteteve të RrGGK-së
- Mbështetja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në vendim-marrje
- Përmirësimi i qasjes së grave në kujdes cilësor shëndetësor
- Zvogëlimi i dhunës në familje dhe trafikim
- Mbështetja për fuqizimin ekonomik të grave

Në këtë raport prezantohen të arriturat gjatë vitit 2013 për secilën nga këto objektiva, duke përfshirë edhe aktivitetet kryesore që kontribuan në arritjen e këtyre rezultateve. Raporti gjithashtu përmban informata rreth buxhetit, mbështetësve financiar, bordit të drejtorëve dhe bordit këshillëdhënës, stafit, praktikanteve, vullnetareve dhe anëtareve.



Anëtares dhe stafi i RrGGK, gjatë takimit në Durrës, Shqipëri, me 3-6 tetor.

NGRITJA E KAPACITETEVE TË RRGKK

Qëllimi kryesor i programit për ngritjen e kapaciteteve është që grupet dhe organizatat e grave në Kosovë, rajon dhe më gjërë, të kenë bashkëpunim dhe komunikim të rregullt, si dhe të organizohen kur janë në pyetje çështjet me interes të përbashkët. Gjatë vitit 2013 është bërë progres drejt arritjes së këtij qëllimi, në veçanti në objektivat që pasojnë. Ne siguroam krijimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të rregullt, të vazhdueshëm ndërmjet anëtareve të RrGGK dhe akterëve të tjerë; është bërë përmirësimi i kapaciteteve institucionale të RrGGK dhe të anëtareve të saj në drejtim të kapacitetit avokues më të madh dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të rrjetit; është rritur niveli i bashkëpunimit në mesin e grave të rajonit drejt drejtësisë tranzicionale, paqes dhe sigurisë. Gjatë vitit 2013, RrGGK ka arritur rezultatet e shënuara më poshtë, të cilat kanë kontribuar në këto objektiva, siç edhe është planifikuar në planin strategjik.

Anëtarët e RrGGK të informuara për iniciativat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGGK, mundësi të financimit dhe informata tjera.

Të gjitha profilet e organizatave anëtare u publikuan në faqen e internetit të RrGGK në të tre gjuhët. RrGGK në mënyrë të vazhdueshme përditëson këto profile në rastet kur anëtarët ndryshojnë informatat e tyre. RrGGK poashtu shton profilet e organizatave të reja anëtare. Tani çdokush mund të mësojë më shumë për organizatat anëtare të rrjetit. RrGGK poashtu prezantoi informata tek palët e interesuara dhe donatorët primarë, për RrGGK-në dhe anëtarët e saj gjatë publikimit të [Ku Janë Paratë për të Drejtat e Grave](#).

RrGGK ka Organizuar Takimet Dymujore

RrGGK ka organizuar pesë takime dymujore të anëtareve: në Prishtinë me 4 shkurt (me 75 pjesëmarrës); në Gjakovë me 8 prill (60 pjesëmarrës); në Prishtinë me 7 qershor (60 pjesëmarrës); në Prishtinë me 2 shtator (70



pjesëmarrës); dhe në Durrës me 3-6 tetor (100 pjesëmarrës). Organizatat anëtare të RrGGK, zyrtarë, përkrahës dhe partnerë të RrGGK-së morën pjesë në këto takime. Gjatë takimeve, anëtarët shkëmbyen informata; bashkëpunuan në organizime; u informuan për aktivitetet që po zhvilloheshin në vazhdimësi nga RrGGK dhe nga organizatat; dhe këmbyen informata për mundësi të sigurimit të fondeve për anëtarët.

Më shumë se 100 anëtare të RrGGK u mbledhën në Durrës të Shqipërisë, prej 3 deri me 6 tetor për një fundjavë shlodhëse, plot debat, argëtim dhe mësim. Pavarësisht nga agjenda e ngjeshur, pjesëmarrëset me plot energji vazhduan diskutimet edhe jashtë aktivitetëve të organizuara. Anëtare të ndryshme me gatishmëri këmbyen njohuritë dhe përvojat e jetës së tyre, duke motivuar dhe inspiruar njëra-tjetrën.

“Një nga pikat e forta të RrGGK është diversiteti i saj,” vuri në pah Lina Andeer, përfaqësuese e Kvinna till Kvinna, organizatë suedeze që e mbështeti takimin. “Ju keni edhe vajza edhe gra. Ju keni gra nga qytetet e ndryshme dhe nga zonat rurale, nga komunitetet e ndryshme etnike dhe gra me aftësi të kufizuara.”

Me të vërtetë, larmia e anëtareve të RrGGK, pjesëmarrëse në këtë takim, ishte frymëzuese. Gjatë fundjavës, ato mbështetën njëra-tjetrën: RrGGK kishte siguruar përkthim të vazhdueshëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, si dhe në gjuhën e shenjave. E në mbrëmje, kur filloi ahengu, të gjitha anëtarët u gjendën në pistën e vallëzimit, duke përfshirë edhe gratë e verbëra dhe personat me nevoja të veçanta fizike që vallëzonin në karriget e tyre me rrota.

Gjatë një punëtorie një-ditore të mbajtur për zgjidhjen e konflikteve, aktivistja frymëzuese e rrezatuese, e njohur edhe botërisht, Shqipe Malushi, i informoi anëtarët me strategji të ndryshme për transformimin e energjisë negative në energji pozitive. Nga frika se ajo mund të hapë plagët që shumë gra ende i vuajnë që nga përfundimi i luftës, ajo u përcolli atyre me kujdes informatat se si të menduarit pozitiv mund të mbështesë gratë për të përballuar realitetin e tyre të përditshëm.



Të menduarit pozitiv mund t'iu mundësojë aktivisteve që të kapërcejnë format e ndryshme të konflikteve, nga ndër-personale tek organizative tek shoqërore. Pjesëmarrëset mirëpritën qasjen e saj unike dhe strategjitë efektive të komunikimit. “Kjo ishte një punëtori shumë pozitive dhe tepër frymëzuese,” tha një pjesëmarrëse.

Ndërkaq, në dhomën tjetër, Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programit në RrGGK, udhëhoqi një diskutim tjetër lidhur me hapat konkretë të planifikimit të një iniciative efektive avokuese. Anëtarët diskutuan për mjetet dhe “mënyrat” e planifikimit lidhur me procesin e avokimit. Pastaj, ato u ndanë në grupe ku planifikuan iniciativa avokuese për të adresuar çështje reale brenda komuniteteve të tyre, të tilla si qasja fizike në ndërtesat publike për personat në karroca, nënat me karroce për fëmijët dhe të moshuarit; sigurim shëndetësor për të gjithë; dhe pensione të mjaftueshme për pensionistët. “Punëtorja për avokim ishte shumë produktive, sidomos angazhimi në grupe ku ne kishim mundësi të krijojmë strategji konkrete të avokimit,” tha një aktiviste. “Shumica nga ne planifikojmë të përdorim këto strategji kur të kthehemi në Kosovë.”

Përveç punëtorive të organizuara gjatë ditës, takimi u plotësua edhe me ngjarje të ndryshme të mbajtura secilën natë. OJQ “Artpolis”, moderoi një diskutim mbi “Fuqizimin e Grave.” Anëtarët shikuan një seri të fotografive që shkaktuan emocione të ndryshme, të cilat pastaj anëtarët i diskutuan së bashku. Anëtarët e RrGGK gjithashtu mirëpritën mysafirë nga OJQ “Gruaja tek Gruaja” nga Shkodra, të cilat u prezantuan me një monolog të fuqishëm dhe humoristik: “Sex. Faleminderit, thjeshtë sa për ta provuar.”

Në mbrëmjen e radhës, aktivistet nga Shqipëria, Delina Fico dhe Xheni Karaj, u bashkuan me anëtarët në diskutimin e kuptimit, koncepteve dhe praktikave të feminizmit në Kosovë dhe Shqipëri. “Ka shumë njerëz të cilët nuk kanë njohuri lidhur me feminizmin,” tha Delina Fico. “Ata mendojnë se feministët i urrejnë burrat, por feminizmi kurrë nuk i ka konsideruar burrat si armiq. Në vend të kësaj, i ka parë ata si pjesë e problemit dhe e zgjidhjes. Kjo shihet qartë nga fakti se në gjithë botën, e edhe në Kosovë, ka burra feministë të cilët janë pjesë e projektit të rishikimit dhe reformimit



të marrëdhënieve gjinore”. Anëtarët e RrGGK pastaj diskutuan për rëndësinë e feminizmit si pjesë e aktivizmit të përkrahjes së mëtutjeshme të të drejtave të grave.

RrGGK shënoi fundin e kësaj fundjave të paharrueshme me një mbrëmje artistike me muzikë, argëtim dhe vallëzim. “Ahengu ishte mënyra më e mirë për t’i dhënë fund këtij takimi. Ne me të vërtetë u argëtuam shumë” u shpreh një aktiviste.

Argëtimi vazhdoi në autobus, gjatë gjithë rrugës për në Kosovë. Takimi kishte përmbushur qëllimin e vet: të transformonte energjinë negative në energji pozitive, motivimin e aktiviteteteve, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet anëtareve dhe ofrimin e strategjive të reja për punën e ardhëshme të anëtareve.

RrGGK përkrah funksionimin e organizatave e grave serbe në Kosovë

Organizatat e grave serbe u përfshinë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga RrGGK. RrGGK poashtu ofroi përkthim në gjuhën e tyre. RrGGK bëri përpjekje të veçanta për tu siguruar që anëtarët serbe të mund të marrin pjesë në takime dhe ngjarje të tjera të organizuara nga RrGGK, duke ofruar transport të sigurtë për ato që nuk kishin çasje në transport publik. Takimet e rregullta të RrGGK janë shumë të rëndësishme për anëtarët serbe të RrGGK, sepse ato mësojnë për përpjekjet e ndryshme që po zënë vend nëpër Kosovë dhe identifikojnë mundësitë për të bashkëpunuar në projekte me anëtarët tjera. Koordinatorja e Fondit të Grave të Kosovës të RrGGK-së ndihmoi organizatat e tyre në shkrimin e aplikacioneve, përmes e-mailit dhe takimeve individuale. Si rezultat i kësaj, dy organizata serbe dorëzuan projekt-propozime tek Fondi i Grave të Kosovës dhe njëra prej tyre u financua pas aprovimit nga Komiteti për Shqyrtimin e Granteve. Organizata nga Shtërpce poashtu pranoi monitorim të vazhdueshëm, veçanërisht sa i përket menaxhimit të projektit dhe raportimit, duke zhvilluar kështu aftësitë e veta organizative.



Anëtarët e RrGGK dhe dukshmëria e punës së tyre

RrGGK gjatë vitit 2013 nëpërmjet postës elektronike dhe Facebook-ut ka shpërndarë informata më shumë se 22 herë lidhur me punën e anëtareve të RrGGK-së. RrGGK pregatiti dhe shpërndau 12 numra të buletinit mujor *Zëri i Grave Kosovare*. Buletini u dërgua përmes e-mailit tek më shumë se 600 abonentë, u publikua në faqen e internetit të RrGGK dhe u promovua përmes Facebook-ut.

Anëtarët e RrGGK aftësohen për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive dhe për të ndërmarr iniciativa më efektive avokuese

RrGGK ka qenë gjithashtu shumë aktive në mbështetjen e anëtareve të saj në zhvillimin për ngritjen e fondeve, të planifikimit dhe kapaciteteve avokuese gjatë këtij vitit. Gjatë vitit 2013, RrGGK gjithashtu ka zhvilluar kapacitetet e saj të brendshme për ngritjen e fondeve. Kjo u vu në dukje nga 72 projekt-propozimet e dorëzuara tek Fondi i Grave të Kosovës dhe 49 projekt-propozimet që anëtarët dorëzuan tek donatorët e tjerë me ç'rast pranuan përkrahje në mentorim nga RrGGK; komentet e atyre që morën pjesë në punëtoritë e Shkrimit të Projekt Propozimeve, Raportimit Narrativ, Raportimit Financiar, Buxhetimit dhe Avokimit; 149 grave të ndryshme të përfshira në proceset vendim-marrëse përmes granteve të FGK për anëtarët; 11 iniciativat e avokimit të ndërmarra nga anëtarët dhe 10 iniciativat e suksesshme të avokimit të cilat ishin efektive në arritjen e rezultateve të tyre.



Anëtarët e RrGGK përfitojnë aftësi të raportimit narrativ dhe financiar në një trajnim të organizuar nga RrGGK me 29 korrik në Prishtinë.

Plani për shërbimet e anëtarësimit

RrGGK vizitoi 81 organizata anëtare në vitet 2011-2012 për të vlerësuar përparimin e bërë në implementimin e Kodit të Etikës dhe Përgjegjësisë të RrGGK, të cilin të gjitha anëtaresit u pajtuan që ta përbushin. Duke u bazuar në intervistat, RrGGK krijoi një raport individual për secilën organizatë me informatat e tyre, nevojat, si dhe anët e forta dhe dobësitë lidhur me funksionimin e tyre organizativ. RrGGK krijoi [Planin për Shërbimet e Anëtarësimit](#) bazuar në intervistat me anëtaresit, kërkesat individuale të anëtareve, vlerësimeve të bëra pas aktiviteteve të organizuara nga RrGGK dhe vëzhgimet e anëtareve të stafit të RrGGK-së.

Mentorim individual dhe trajnim për implementimin e mëtutjeshëm të Kodit

Organizatat anëtare të RrGGK-së punuan së bashku dhe përkrahën njëra-tjetrën në shkrimin e projekt propozimeve dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta. Si pjesë e Fondit, stafi i RrGGK-së ishte në kontakt me anëtaresit e RrGGK 830 herë gjatë vitit 2013. Më tutje, RrGGK ofroi ndihmë pa pagesë për anëtaresit lidhur me përkthimin, shkrimin e projekt propozimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar. Gjatë vitit 2014, RrGGK do të vazhdojë të ofrojë mentorim individual për anëtaresit drejt implementimit të mëtutjeshëm të [Kodit të Mirësjelljes së RrGGK](#), të miratuar nga anëtaresit.

RrGGK ka filluar Iniciativën e re për Ngritjen e Fondeve

Financimi i donatorëve për shoqërinë civile është në rënie e sipër gjatë kësaj dekade. RrGGK nuk duan që këto ndrrime nga financimet e huaja të rrezikojë punën në shërbimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave në Kosovë dhe më gjerë. Prandaj, rrjeti ka iniciuar një nismë të re për ngritje të fondeve gjatë vitit 2013. Fillimisht, anëtaresit e stafit dhe bordit të RrGGK kanë bashkëpunuar për të hartuar një strategji për ngritjen e fondeve të RrGGK. Në bazë të kësaj strategjie, RrGGK ka bërë një sërë përpjekjesh tjera.



Midis tyre, RrGGK ka krijuar një fond të ri të qëndrueshmërisë, i cili mbështet kostot e rëndësishme që RrGGK nuk mund të mbulojë me financimin nga donatorët tradicional. RrGGK gjithashtu krijoi një [vizion](#) afatgjatë për ngritjen e fondeve (foto në anën e djathtë), të cilin e ka shpërndarë te mbështetësit potencialë të interesuar.

RrGGK ka krijuar një partneritet me East-West Management Institute (EWMI) në Nju Jork, përmes të cilit individët tani mund të bëjnë [donacione pa taksa online](#) për RrGGK.

Tabela 1 përmbledh ë gjitha burimet e fondeve që RrGGK mblodhi gjatë vitit 2013 nga burime të reja, të ndryshme, që kap shumën totale €9,303. Siç sqaron tabela, disa donacione janë të papërcaktuara, duke i mundësuar RrGGK-së që

Tabela 1. Ngritja e fondeve të RrGGK nga burimet alternative gjatë vitit 2013

Burimi	Të përdoren për	Shuma
East-West Management Institute (<i>përfshin të gjitha donacionet për RrGGK nga qytetarët e SHBA-ve dhe ato të bazuara në internet</i>)	Të papërcaktuara (<i>disa të rezervuara për Iniciativën e Historisë Gojore</i>)	€2,958
Donacionet nga qytetarët e SHBA-ve (para të gatshme)		€400
Anëtarët Individual	Të papërcaktuara	€295
Organizatat anëtare	Të papërcaktuara	€1,780
New School, New York	Iniciativa e Historisë Gojore	€2,523
Huazimi i paisjeve edituese të RrGGK	Të papërcaktuara	€700
Shërbimet: Mendimi i ekspertit për Chantal Desloges, Kanadë	Të papërcaktuara	€647
Totali		€9,303

të përzgjedhë mënyrën më të mirë për t'i shfrytëzuar këto fonde, duke u bazuar në misionin e saj. Mementalisht, këto fonde janë në Fondin e Qëndrueshmërisë të RrGGK-së, përveç nëse tregohet ndryshe. Përveç këtyre, RrGGK ka siguruar kontribute vetanake të rëndësishme nga një numër biznesesh dhe individësh në Kosovë (për më shumë informata, shikoni Raportin Financiar të RrGGK-së më poshtë).



RrGGK ka Zhvilluar Programin e Ri për Anëtarësim

Në vitin 2013, RrGGK ka zhvilluar Programin për Anëtarësimin Individual që lejon individët t'i bashkangjiten RrGGK-së. Organizatat anëtare të RrGGK tani bëjnë një pagesë vjetore për anëtarësim. Pagesat e anëtarësimit mund të shërbejnë si donacione që nuk tatohen për anëtarët individual që banojnë në SHBA, nëpërmjet EWMI, partnerit të RrGGK.

Bashkëpunëtorët e RrGGK nuk duhet të paguajnë tarifën e anëtarësimit dhe mund të marrin pjesë në aktivitetet e RrGGK dhe të marrin informatat lidhur me rrjetin. Megjithatë, ata nuk mund të jenë pjesë e vendim-marrjes për aktivitetet e rrjetit.

Përfitimet që merr çdo lloj i anëtarit janë të përcaktuara në politikën e re të anëtarësimit. Të gjitha tarifat e anëtarësimit kontribuojnë në Fondin e Qëndrueshmërisë së RrGGK dhe janë pjesë e përpjekjeve më të gjera të RrGGK-së për të diversifikuar burimet e saj në drejtim të sigurimit të qëndrueshmërisë afatgjatë të rrjetit dhe aftësinë e rrjetit për të reaguar për çështje emergjente që prekin të drejtat e grave, kur kufizimet kohore nuk lejojnë sigurimin e donatorëve financiar. Për më tepër, Anëtarët e RrGGK mund të ndjehen krenar që janë pjesë e një rrjeti botëror të njerëzve të angazhuar për mbështetjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave në Kosovë. RrGGK mirëpret burrat ti bashkangjiten këtij qëllimi; ne tashmë kemi tre burra si anëtarë individual.



Më 30 Korrik, RrGGK mirëpriti anëtarën e parë individuale Elizabeth Kaestli, përkrahëse për një kohë të gjatë e shtytjes përpara të të drejtave të grave në Kosovë.

RrGGK ka Shkëmbyer Ide Alternative për Ngritje të Fondeve për Organizatat



Financimi për organizatat e grave, veçanërisht ato që punojnë në nivel lokal, është bërë gjithnjë e më i vështirë për tu siguruar. Pasi që ndihma ndërkombëtare në Kosovë është në rënie, është e rëndësishme për anëtarët e RrGGK të përfshijnë mbështetës të ndryshëm. Prandaj, në bazë të kërkesave nga organizatat tona anëtare dhe ideve të përbashkëta gjatë ekskursionit vjetor të vitit 2012, RrGGK ka hartuar një manual me titull Alternativat për ngritje të fondeve, në tri gjuhë, në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK. Manuali përfshin 16 ide të reja për anëtarët e RrGGK për të siguruar fonde për mbështetjen e punës së tyre.

RrGGK dhe Alter Habitus kanë Publikuar Raportin “Ku janë Paratë për të Drejtat e Grave?”

Organizatat për të drejtat e grave luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen dhe krijimin e institucioneve demokratike, avancimin e të drejtave të grave si të drejta të njeriut, ndryshimin e normave gjinore, ngritjen e vetëdijes publike, ofrimin e shërbimeve për grupe të marginalizuara (veçanërisht kur mungon përkrahja nga shteti) dhe kërkimin e llogaridhënies nga qeveria përmes avokimit”. Të gjitha këto aktivitete kërkojnë angazhim dhe burime.

Kështu, në studimin e saj tetëvjeçar të vazhdueshëm global, Shoqata për të Drejtat e Grave në Zhvillim (AWID) ka kërkuar: “Ku janë paratë për të drejtat e grave?” RrGGK në partneritet me Alter Habitus Institutin për Studime në Kulturë dhe Shoqëri (AH) kanë dashur të kontribuojnë me njohuritë e tyre për hulumtim më të gjerë të AWID nëpërmjet një studimi rasti në Kosovë. Deri në çfarë mase rrjedhin trendet globale të financimit në vende të veçanta (pas konflikteve), si p.sh. Kosova, dhe çfarë mund të ndryshojnë?



Pasi që Kosova pëson ndërrime të rëndësishme politike që potencialisht ndikojnë në praktikat e ndihmave financiare, hulumtimi gjithashtu ofron informata vitale në lidhje me trendet e financimit në Kosovë, të cilat mund të përshtaten në planifikimin strategjik të donatorëve dhe të organizatave për të drejtat e grave. Në mënyrë më specifike, ky hulumtim shqyrton: rëndësinë që ka mbështetja e organizatave të grave në proceset e ndryshimeve shoqërore; ndryshimet historike në trendet e financimit mes viteve 2000 dhe 2013; qëndrueshmëria financiare e organizatave të grave; trendet që ndikojnë në vendimet e donatorëve për financimin (ose mos financimin) e organizatave të grave dhe mundësitë e bashkëpunimit mes organizatave të grave dhe donatorëve në krijimin e strategjive të përbashkëta për mobilizimin e resurseve dhe mekanizmave të financimit për organizatat e grave. Raporti gjithashtu sjell rekomandime për të gjitha grupet e interesit: për qeverinë, organizatat jo-qeveritare të grave dhe donatorët, në atë se cilat do të ishin mënyrat më të mira për të sjell rezultate të frytshme në fushën e avancimit të barazisë gjinore në Kosovë, si dhe krijimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për mobilizimin e resurseve nga perspektiva e lëvizjes feministe.

Hulumtimi i zhvilluar mes janarit dhe shtatorit të vitit 2013, përfshin kontaktet me 40 donatorë që kishin operuar në Kosovë, një studim prej 90 organizatave të grave, një rishikim të literaturës ekzistuese dhe kontrollat e pjesëmarrësve ndaj vlefshmërisë. RrGGK ka publikuar raportin final me 18 nëntor në një audiencë të përbërë nga më shumë se 40 përfaqësues të donatorëve dhe organizatave jo-qeveritare. Pati një diskutim të frytshëm të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ishte pajtim unanimit nga të gjithë pjesëmarrësit se një koordinim më i mirë mes donatorëve, organizatave të grave, dhe qeverisë do të ndihmonte në avancimin e të drejtave të grave. Për më tepër, Fondi i Grave të Kosovës brenda Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, i cili kombinon grante të vogla me trajnim intensiv dhe mentorim për organizata, u pa si zgjidhje potenciale për donatorët të cilët dëshirojnë të përkrahin organizatat e vogla, të cilat nuk e kanë kapacitetin për të konkuruar me organizatat e mëdha, mirëpo, që bëjnë punë shumë të rëndësishme me grupet rurale dhe të marginalizuara. Gjithashtu, organizatat e grave kërkuan kontrata afatgjate me donatorët, sepse

kjo do t'u mundësonte organizatave të zbatojnë strategjitë drejt vizionit të tyre afatgjatë. Për to, përkrahja afatgjatë qartazi ndikon në forcimin e lëvizjes së grave në Kosovë dhe avancimin e ndryshimeve shoqërore. "Ku janë paratë për të drejtat e grave?" është mbështetur nga AWID dhe Kvinna till Kvinna.

RrGGK ka Përfunduar tri Raunde të Fondit të Grave të Kosovës

Në përpjekje për tu mundësuar organizatave të grave qasje në burime, si dhe për të ngritur kapacitetet e tyre organizative, RrGGK ka vazhduar aktivitetet si pjesë e Fondit të Grave të Kosovës, i krijuar në vitin 2012 në konsultim të ngushtë me anëtarët e saj. Këtë vit RrGGK ka rritur shumat e granteve nga maksimumi prej 1,000 € sa ishte në vitin 2012 deri në 3,000 € në

vitin 2013. Përmes Fondit të Grave të Kosovës, 22 organizata kanë pasur mundësi të zbatojnë idetë e tyre duke pasur përfitues të ndryshëm në pesë rajonet e Kosovës. Iniciativa ka arritur disa nga grupet më të rrezikuara të Kosovës, sidomos të atyre që jetojnë në zonat rurale dhe minoriteteve, disa nga të cilët kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla për herë të parë. Për më tepër, shumica e organizatave kanë arritur më shumë përfitues se sa që kishin planifikuar në projekt propozimet e tyre. Disa organizata dhe përfituesit e tyre vazhduan të ndërmarrin nisma të tjera shtesë mbi baza vullnetare edhe pasi projektet e tyre të financuara nga RrGGK përfunduan.

Duke fokusuar iniciativat e tyre në pesë objektivat strategjike të lartpërmendura të RrGGK-së, Fondi ofroi një mundësi të shkëlqyer për anëtarët për të kontribuar më shumë në drejtim të realizimit të strategjisë së përbashkët të RrGGK.



Gratë në Komunë e Skënderajt marrin pjesë në ligjëratat e organizuara nga OJQ Prehja lidhur me kancerin e gjirit.



Anëtarët kanë forcuar edhe marrëdhëniet e tyre me rrjetin dhe me anëtarët tjerë. Organizatat anëtare të RrGGK punuan së bashku dhe mbështetën njëra-tjetrën me shkrimin e projekt-propozimeve dhe realizimin e iniciativave të përbashkëta. Më shumë anëtare kanë fituar gjithnjë e më shumë vetëbesim për të aplikuar me projekt-propozime tek donatorët e rinjë. Nëpërmjet Fondit, anëtarët e RrGGK janë motivuar edhe më shumë në ndërmarrjen e nismave të avokimit, duke besuar se aktivizmi mund të avancojë të drejtat e grave. Shumica e anëtareve kanë çuar më tej aftësitë e avokimit përmes “metodës së të mësuarit - duke bërë” të Fondit; ato kanë avokuar te institucionet komunale, duke krijuar dhe forcuar bashkëpunimin midis organizatave të grave dhe institucioneve komunale.

RrGGK ka mbështetur anëtarët për tu siguruar që puna e tyre ishte e dukshme përmes pjesëmarrjes në programe televizive, artikuj të gazetave ditore, duke marrë pjesë në ngjarje të ndryshme (p.sh., panairë, konferenca, etj), dhe përmes faqes së internetit të RrGGK, faqes në Facebook dhe artikujve në buletin dy mujor të RrGGK Zëri i Gruas Kosovare.

Njëzet e dy organizata që kanë marrë grante nga Fondi i Grave të Kosovës RrGGK në vitin 2013, arrijnë shumën 66,209 €, dhe iniciativat e tyre përfshijnë:

- 1) Qendra për Zhvillimin Ekonomik të Grave në Shtërpce “*Ikebana*” ka fuqizuar ekonomikisht gratë e komunës së tyre duke kultivuar bimë mjekësore. Ato fuqizuan ekonomikisht gratë, duke përmirësuar aftësitë e tyre për tharjen dhe përpunimin e bimëve dhe frutave. (2,707 €)
- 2) Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim ka fuqizuar ekonomikisht gratë dhe ka ngritur aftësitë e tyre të biznesit nëpërmjet tharjes dhe përpunimit të frutave dhe mjeteve për prodhimin e pastave dhe ëmbëlsirave. Ato përfshijnë gratë kryefamiljare nga Komuna e Novobërdes në avokimin e suksesshëm që Zyrtari për Barazi Gjinore të përfshijë mbështetjen për to në planin buxhetor të komunës. (2,600 €)



- 3) *Gruaja Hyjnore* ka fuqizuar gratë në rajonin e Gjilanit përmes punëtorive për barazi gjinore, të drejtat e grave në trashëgimi të pronës dhe teknikat e avancuara të artit e punëve artizanale. Ato avokuan me sukses për të siguruar hapësirë për zyre pa pagesë nga Komuna e Gjilanit. (2,420 €)
- 4) *Parajsa Jonë* ka zhvilluar aktivitete trajnuese dhe ka promovuar hortikulturën dhe sipërmarrjen për gratë në zonat rurale të komunës së Lipjanit. Drejtoresha Egzekutive, si anëtare e Grupit Joformal të Grave nga Lipjani, ka vizituar gjashtë herë kryetarin e Komunës së Lipjanit për të avokuar që nevojat e grave të përfshihen në buxhetin e komunës. (2,656 €)
- 5) Shoqata e të Shurdhërve në Prizren ka organizuar vizita sistematike gjinekologjike dhe trajnime shëndetësore për gratë që nuk dëgjojnë. Ato avokuan me sukses që Komuna e Prizrenit të financojë interpretimin/përkthimin për personat e shurdhër. (2,514 €)
- 6) Shoqata e Grave Fermere “*Krusha e Vogel*” ka fuqizuar gratë ekonomikisht në zonat rurale, në fshatrat Krushë e Vogël dhe Has (Komuna e Prizrenit) me anë të seminareve për menaxhimin e biznesit, marketing, higjienën e qumështit dhe ndarjen e përvojave me fermerët nga OJQ-të tjera. (2,390 €)
- 7) Qendra e Grave *Prehja* ka organizuar trajnime, takime dhe diskutime publike për shëndetin e grave që vuajnë nga kanceri i gjirit në Skenderaj. Ato përfshinë një grup të grave nga fshati Syriganë për të avokuar që OJQ Mundësia nga Mitrovica t’iu mundësoi transport pa pagesë deri në Prishtinë për të kryer vizita gjinekologjike. (2,160 €)
- 8) OJQ *Lulebora* nga Prishtina ka ofruar këshilla dhe kontrolla gjinekologjike për gratë dhe vajzat romë në lagjen e Romëve në Mitrovicë. Ato avokuan me sukses tek Zyrtari për Barazi Gjinore në Mitrovicë që t’iu ndihmojë në realizimin e 100 vizitave gjinekologjike për gratë e komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Mitrovicë. (1,370 €)
- 9) Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave ka identifikuar raste të dhunës të ushtruar gjatë luftës në 17 fshatra të komunës së Drenasit. Ato organizuan takim me Presidenten e Kosovës, e cila iu premtoi krijimin e një Fondi të dedikuar grave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Presidentja, që nga atëherë ka krijuar një Këshill Kombëtar për të ndihmuar gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. (2,570 €)



- 10) Rona ka fuqizuar ekonomikisht gratë, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në sferën e turizmit duke prodhuar punë dore dhe duke promovuar trashëgiminë kulturore në Gorë dhe Opojë. (2,800 €)
- 11) Foleja ka vetëdijësuar gratë dhe vajzat egjiptase, roma dhe ashkali në Prizren, Landovicë, Piranë, Serbicë Jugore dhe Mamushë për shëndetin dhe të drejtat e tyre. (2,740 €)
- 12) Rikotta ka nisur “Tregun e Grave” në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë, duke bërë shitjen e punimeve të grave dhe organizimin e ngjarjeve në rrugë për të ngritur vetëdijen për të drejtat e grave. Ato avokuan tek kryetari i Komunës së Prishtinës për të siguruar një vend në sheshin e qytetit, të cilin “Piazza e Grave” do ta shfrytëzojë pa pagesë edhe gjatë vitit 2014. (2,990 €)
- 13) Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës është angazhuar në integrimin e fëmijëve të verbër në shkollat publike në Prishtinë. Ato avokuan me sukses që dy shkolla fillore pilot të ofrojnë informata për nxënësit e verbër. (2,870 €)
- 14) *Bliri ka ngritur vetëdijen për shëndetin riprodhues në mesin e vajzave në Drenas.* (2,500 €)
- 15) *Venera ka ndihmuar gratë në Pejë të përgatisin dokumentet ligjore dhe të ofrojnë këshilla për kompletimin e procedurave për të hapur biznesin e tyre. Ato ndihmuan 20 persona (shumica prej tyre gra) në avokim tek institucione të ndryshme për të drejtat e tyre.* (2,666 €)
- 16) *Alma ka punuar në identifikimin e grave dhe fuqizimin ekonomik të tyre në dy bashkësitë lokale të Lutogllavës dhe Leshanit në Komunën e Pejës.* (2,854 €)
- 17) *Hendifer ka organizuar vizita gjinekologjike dhe trajnime për parandalimin e kancerit të gjirit dhe mitrës për gratë nga fshatrat e Balaj, Nerodime, Greme, Komogllavë, Zaskok dhe Slivovë. Ato bashkëpunuan me Departamentin komunal të Shëndetësisë në Ferizaj, për të avokuar tek Ministria e Shëndetësisë për një aparat për mamografi.* (2,630 €)
- 18) *Gora ka planifikuar të fuqizojë ekonomikisht gratë gorane nga Dragashi, duke krijuar punime dore dhe shitjen e tyre në panaire të ndryshme.* (2,780 €)



- 19) Shoqata për Edukim dhe Përkujdes Familjar do të organizojë seanca arsimore, tryeza të rrumbullakëta dhe kuize për të rinjtë nga Komuna e Gjakovës me temën “mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse seksuale”. (2,390 €)
- 20) *Gruaja Bashkëkohore* do të organizojë ligjërata shëndetësore, trajnime psiko-sociale dhe ushtrime në palestër për të zëvendësuar fizioterapinë. Ato gjithashtu do të avokojnë në spitalin rajonal të Prizrenit për të ofruar shërbime më të mira për personat me aftësi të kufizuara. (2,065 €)
- 21) Shoqata Iniciativa e Grave do të mbaj trajnime për gratë nga fshati Bresanë të Dragashit në rrobaqepësi, duke dashur ti mbështes ato me mundësitë e punësimit në fabrika. Ato kanë ndihmuar vajzat që të avokojnë tek kryetari i Komunës së Dragashit që t’iu ndihmojë në uljen e numrit të vajzave analfabete dhe për të vazhduar iniciativën e tyre për rrobaqepësi për dy muaj. (3,000 €)
- 22) Organizata e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës do të organizojnë aktivitete të ndryshme për personat me nevoja të veçanta nga Prishtina, Gjilani, Ferizaji, Mitrovica dhe Prizreni, duke përfshirë edhe zonat rurale. (2,700 €)

RrGGK ka Organizuar disa Punëtoritë për Ngritje Kapacitetesh për Anëtarët

RrGGK vizitoi 81 nga organizatat e veta anëtare gjatë viteve 2011-2012 për të vlerësuar përparimin e bërë në implementimin e [Kodit mbi Etikën dhe Përgjegjësitë](#) e RrGGK-së. Gjatë këtyre intervistave gjithëpërfshirëse, RrGGK identifikoi nevojat e anëtareve, të cilat u përmblodhën në [Raporti i Monitorimit të Kodit të Mirësjelljes të RrGGK & Plani i Ngjirtjes së Kapaciteteve për Anëtarët](#) i RrGGK-së. RrGGK vazhdoi të vizitoi organizatat e reja anëtare për të përcaktuar kapacitetet e tyre, me qëllim të ofrimit të përkrahjes adekuate për zhvillimin e kapaciteteve. RrGGK poashtu identifikoi nevojat e anëtareve gjatë vizitave që u bënë lidhur me Fondin e Grave të Kosovës të RrGGK. Duke u bazuar në këto vlerësime, RrGGK organizoi një sërë punëtorish për anëtarët e saj gjatë vitit 2013. Punëtoritë u organizuan me pas ose aspak kontribut financiar falë kontributit të Villa Germia, Hotel Sirius dhe anëtareve të RrGGK.



Shkrimi i Projekt-Propozimeve II

RrGGK ka mbajtur një punëtori për shkrimin e projekt-propozimeve në Prishtinë, më 28 shkurt deri më 2 mars, duke u përgjigjur kërkesave të anëtareve. “Unë u jam me të vërtetë mirënjohëse RrGGK-së për organizimin e punëtorive të tilla. Ato na ndihmojnë shumë”, tha Gjejrane Lokaj nga Shoqata Iniciativa e Grave në Dragash. “Edhe pse Dragashi është larg nga Prishtina, ndihem shumë e afërt me stafin e RrGGK sepse unë e di se ato janë gjithmonë aty për të na mbështetur”. Punëtorja treditore interaktive mbledhi 52 pjesëmarrëse nga organizata të ndryshme anëtare të RrGGK. Punëtorja ka mbuluar pjesën e analizës së problemeve, analiza objektive, kornizat logjike, monitorimin dhe vlerësimin. Punëtorja është financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), si një vazhdim i punëtorisë fillestare të organizuar në dhjetor 2012.



Anëtares e RrGGK marrin pjesë në një punëtori tre-ditore interaktive për shkrimin e projekt-propozimeve, më 28 shkurt deri më 2 mars.

Shkrimi i Komunikatave Efektive për Shtyp



Pjesëmarrëset bashkëpunojnë, për të krijuar një kumtesë për media gjatë punëtorisë së MP të RrGGK, më 19 prill.

Me 19 prill në Prishtinë, RrGGK ka mbajtur punëtorinë njëditore për marrëdhëniet publike. Të 35 pjesëmarrëset diskutuan sfidat me të cilat përballen në marrëdhëniet publike, nevojat e tyre dhe strategjitë e mundshme për promovimin e punës së tyre. Ato gjithashtu mësuan teknika për shkrimin e komunikatave efektive për shtyp. “Të gjitha anëtares duhet të marrin pjesë në këto lloj punëtorish, edhe ato që kanë më shumë përvojë”, tha një pjesëmarrëse në punëtori. “Është gjithmonë diçka e re për tu mësuar”.

Anëtares e RrGGK vënë njohuritë e tyre të reja në praktikë, duke shkruar komunikatë për shtyp që më vonë mori kritika konstruktive nga pjesëmarrëset tjera të punëtorisë.

Bazat e Fotografisë

Me 28 maj, RrGGK organizoi një trajnim mbi bazat e fotografisë. Trajnimi u mbajt në parkun e Gërmisë, poashtu ishte si relaksues edhe informativ. Të 25 pjesëmarrëset mësuar elemente që duhet ti marrin në konsideratë në nxjerrjen e fotografive të mira, të tilla si drita, reflektim, veprim, përbërja dhe etika (p.sh., kur duhet të kërkojë leje për të nxjerrë fotografi). “Ky trajnim ishte me të vërtetë i nevojshëm” tha Sylbije Sahiti nga OJQ Parajsa Jonë. “Na ndihmoi të mësojnë për të nxjerrë fotografi të qarta dhe tani ne mund të portretizojmë më mirë aktivitete dhe ngjarje në OJQ tonë”. Përfaqësueset e OJQ-ve menjëherë sprovuan njohuritë e tyre të reja në praktikë, duke nxjerrë fotografi brenda dhe jashtë në parkun e Gërmisë.

Raportimi Narrativ, Raportimi Financiar dhe Buxhetimi

Rreth 37 përfaqësuese të organizatave anëtare të RrGGK mbushën sallën në Hotel Prishtina më 29 korrik për një trajnim në raportimin narrativ, raportimin financiar dhe buxhetimin. Anëtarët e RrGGK kishin kërkuar mbështetje në këto pika. Shkrimi i raporteve të mira është i rëndësishëm për të demonstruar te përfituesit, anëtarëve të komunitetit dhe donatorëve rezultatet që anëtarët kanë arritur përmes projekteve të tyre. Për këtë arsye, stafi i RrGGK u ka ofruar organizatave anëtare një punëtori një ditore për të mësuar teknikat më të dobishme në të shkruarit e raporteve.

Ato diskutuan gjithashtu rëndësinë e marrjes së raporteve interesante për të lexuar. “Tema e punëtorisë është shumë e mirë, sidomos për OJQ-në tonë e cila u formua së fundmi”, tha një pjesëmarrëse. Gjatë pasdites, Besa Shehu, menaxherja e administratës dhe financave të RrGGK, u shpjegoi modele të raportimit financiar. Ajo ka dhënë këshilla se si organizatat mund të forcojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar, si dhe të paraqesin raporte të sakta financiare. “Ky trajnim është shumë i dobishëm për OJQ-në tonë”, tha një tjetër pjesëmarrëse. “Kur vjen koha për të raportuar për grantin që kemi fituar, ne do të dijmë më mirë se si të shkruajmë raportin”. Stafi i RrGGK gjithashtu ka ofruar këshillime për anëtarët në mënyrë që ato të mund të praktikojnë njohuritë e tyre të reja për ti përdorur në punën e tyre ditore.

RrGGK ka Organizuar Forumin Rajonal të Feministeve të Reja 2013

Me 13-14 nëntor 40 feministe të reja nga Kosova (Prishtina, Gjakova, Peja, Prizreni, Gjilani dhe Mitrovica) dhe nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia, Kroacia) u mbledhën në Prishtinë. Takimi i organizuar nga RrGGK dhe mbështetur nga KTK, Forumi Rajonal i Feministeve të Reja 2013 përfshiu vajza të cilat diskutuan strategjitë e avokimit, feminizmin dhe pjesëmarrjen e grave në vendim-marrje. Vajzat e reja nga Kosova dhe rajoni prezantuan aktivitetet e tyre të avokimit bën shkëmbimin e informatave dhe mësimuan nga përvojat e njëra-tjetrës. Pastaj ato kanë përdorur këto informata në veprime avokuese të fokusuara brenda grupeve të vogla punuese. Ditën tjetër ato kryen veprimet e tyre avokuese.

Grupe të vogla duke u fokusuar në “psikologët në shkollë” dhe “qasjen në arsim” u takuan me zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. “U habita nga vullneti i zyrtarëve të MASHT-it për t’iu përgjigjur pyetjeve tona duke na dhënë edhe rekomandime praktike” tha një feministe e re.

Një tjetër grup i feministeve të reja zhvilluan “Deklaratën e Forumit Rajonal të Feministeve të Reja 2013”. Ato vizituan zonjën Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, për ti prezantuar gojarisht rekomandimet që dolën nga ky Forum. Presidentja ishte shumë e vëmendëshme, e përkushtuar dhe përkrahëse. Ajo tha se vajzat e reja janë e ardhmja e Kosovës dhe ato duhet të kenë mbështetje permanente. Pas takimit zyrtar, Presidentja diskutoi edhe çështje të tjera me të rejat.

“Presidentja e Kosovës na përshëndeti ngrohtësisht, shprehu interes në atë që ne kishim për të thënë dhe madje e zgjati takimin edhe për 15 minuta shtesë” tha një feministe e re. “Takimi me Presidenten nuk është diçka që ne mund të bëjmë çdo ditë, kështu që ishte e veçantë”.

Grupi i punës në media u përqendrua se si të shkruajnë një artikull të thjeshtë dhe se si të përcjellim informatën të publiku. Ato gjithashtu diskutuan se si media i paraqet gratë dhe vajzat, duke përfshirë edhe gjuhën e përdorur dhe raportimin jo etik, të cilat mund të kenë efekte negative në besimin e publikut të përgjithshëm në media.



“Një gjë shumë e rëndësishme që kemi mësuar gjatë Forumit është se nëse lexojmë, dëgjojmë apo të shikojmë në lajme diçka të papërshtatshme ose të pasaktë, ne duhet të raportojmë në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës apo te Komisioni i Pavarur për Media, në varësi të llojit të Medias” tha një e re. Anëtarët e grupit praktikuan të shfaqen para kamerës dhe duke iu përgjigjur pyetjeve si intervistë. Në ditën e dytë, tri vajza të reja u intervistuan në programin e mëngjesit në RTV 21, duke vënë në praktikë aftësitë e tyre të reja.

Grupi i fundit, Arti dhe Organizimi, përgatiti një Aksion në Rrugë të mbështetur nga Artpolis. Shtatë vajza të reja përgatitën një performancë për të adresuar çështjen e “Diskriminimi në Punë - Promovimi në Punë” për gratë. Të gjitha pjesëmarrëset e forumit u mbledhën para Teatrit Kombëtar, ku ky grup paraqiti performancën e tyre, të përcjellur nga mediat. “Akcioni në rrugë ishte një shembull konkret i asaj që ju mund të arrini duke u organizuar dhe duke punuar në grupe” tha një feministe e re. “Unë mendoj se ne me të vërtetë kemi përçar mesazhin te kalimtarët që ndaleshin për të parë performancën, si dhe përmes të gjitha stacioneve televizive të pranishme atje”.

Pas dy ditëve produktive, pjesëmarrëset shqyrtuan deklaratën përfundimtare të forumit, dhanë sugjerime për përmirësimin e saj dhe votuan për miratimin e saj. Në deklaratën përfundimtare të Forumit, vajzat e reja kërkojnë zbatimin e kuotës 30 % për pjesëmarrjen e grave dhe të burrave në proceset e vendim-marrjes; zbatimin e ligjit të arsimit parauniversitar; sigurimin e transportit dhe librave për të gjithë nxënësit që ndjekin arsimin e detyruar; përfshirjen e psikologëve në shkollë dhe zbatimin e kodit të mirësjelljes për mediat e shkruara dhe elektronike.

Deklarata i është dërguar Presidentes së Republikës së Kosovës, zonjës Atifete Jahjaga, Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Financave, Agjencionit për Barazi Gjinore, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisionit të Pavarur për Media dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.



Gratë e Rajonit Rrisin Bashkëpunimin

RrGGK ka vazhduar rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me organizatat e grave në rajon dhe jashtë vendit përmes 1) një konference në Tiranë, për të drejtat e personave lesbike, homoseksualë, biseksualë dhe transeksualë (LGBT); 2) një ngjarje të organizuar nga Savka Todorovska, aktiviste për të drejtat e grave tash e një kohë të gjatë në Maqedoni, ku Drejtoresha e RrGGK-së foli për punën bashkëpunuese të RrGGK drejt strategjisë së saj; dhe 3) shkëmbimin e përvojave dhe rrjetëzimeve me organizata të ndryshme në New York, duke përfshirë OJQ-në e OKB-së që punon për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Rrjetin e Grave Lindje-Perëndim dhe Global Goods (në lidhje me fuqizimin ekonomik të grave). RrGGK gjithashtu ka mbajtur kontakte me organizata të tjera në rajon lidhur me Qasjen e Feministeve në Drejtësinë Tranzicionale.



Në Split, pjesëmarrëset diskutojnë për iniciativat drejt fuqizimit të vajzave.

Vajzat e Reja nga Kosova dhe Serbia Krijojnë Strategji

Vajza të reja nga Kosova dhe Serbia u takuan në Split, Kroaci me 07-11 qershor. Gjithashtu iu bashkangjitën edhe gratë e reja nga Kroacia, Armenia dhe Azerbajxhani. Ato diskutuan të drejtat e personave LGBT, si dhe shkëmbyen informata dhe përvoja. Ato gjithashtu morën pjesë në paradën për të drejtat e personave LGBT. Që nga viti 2011, Kvinna till Kvinna (KTK) ka mbështetur fuqizimin e vajzave të reja nga Kosova dhe Serbia përmes vizitave studimore. Ky ishte takimi i tyre i katërt. Vizitat e mëparshme janë mbajtur në Izrael/Palestinë, Kosovë dhe Serbi. Vizitat studimore kanë krijuar miqësi të forta në mesin e pjesëmarrëseve. “Ne tani kemi dikë në Kosovë dhe vajzat e Kosovës kanë dikë që



ato mund ta kontaktojnë dhe të bashkëpunojnë me to, pavarësisht nga problemet midis dy vendeve tona” tha një pjesëmarrëse nga Serbia. Vajzat e reja nga rajoni tashmë kanë nisur bashkëpunimin për iniciativat e përbashkëta

5000 Feministë (përfshirë edhe meshkujt) Diskutojnë për të Drejtat e Kujdesit Shëndetësor

Rreth pesë mijë pjesëmarrës nga gjithë bota morën pjesë në [Konferencën e Tretë Globale 2013](#) organizuar nga “Women Deliver” me 28-30 maj, në Kuala Lumpur, Malajzi. Krerët e qeverisë, politikëbërësit, profesionistët e kujdesit shëndetësor, përfaqësues të OJQ-ve, udhëheqësit e korporatave dhe degët globale të mediave nga 150 vende të botës u mbledhën për të diskutuar qasjen e grave për kujdesin shëndetësor.

Shumica e pjesëmarrësve kishin ardhur nga Afrika, Amerika Latine dhe Azia. Shumë pak ishin nga Evropa, por në mesin e tyre ishte Mimoza Paçuku, kordinatore e projektit të RrGGK-së, [Fondi i Grave të Kosovës](#). “Isha e lumtur që prezantova Kosovën në ngjarjen më të madhe globale të dekadës të organizuar për shëndetësi” tha ajo. Pjesëmarrësit prezantuan çështje me të cilat të rinjtë nga vendet e tyre përballen në procesin e ndryshimit të politikave, duke përfshirë Kathy Calvin, Kryetar dhe Shef Ekzekutiv i [Fondacionit të Kombeve të Bashkuara](#); Barbara Bush, bashkë- themeluese e [Korporatave Shëndetit Global](#); Kate Gilmore, Zëvendës Drejtore Ekzekutive e [UNFPA](#); Joy Marini, Drejtor, [Kontributet e Korporatave Johnson & Johnson](#), Princesha Mabel e Holandës; dhe Pricessa e Danimarkës Mary.

“Isha e lumtur që po përfaqësoja Kosovën në ngjarjen më të madhe botërore të dekadës të organizuar mbi shëndetin.”
– Mimoza Paçuku, Koordinatorë e RrGGK

Gratë Kosovare mbështesin krijimin e Gjykatës së Grave

Përfaqësuese të RrGGK kanë marrë pjesë në tri takime përgatitore në Lubjanë, Kotor dhe Zagreb për krijimin e Gjykatës së Grave. RrGGK mban kontakt të vazhdueshëm me palët e interesuara për organizimin lidhur me Gjykatën e Grave.



RRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIM-MARRJE

Qëllimi afatgjatë i këtij projekti është “Gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe në vendim-marrje në nivel komunal dhe kombëtar”. Në vitin 2013, RrGGK ka arritur qëllimin afatshkurtër për rritjen dhe përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe në marrjen e vendimeve në nivelet komunale dhe kombëtare. Më konkretisht, RrGGK ka arritur rezultatet e mëposhtme.

Gratë në politikë, OJQ-të e grave dhe gratë votuese komunikojnë dhe bashkëpunojnë me shumë rreth çështjeve që gratë i konsiderojnë si prioritare

Me përkrahjen e RrGGK-së, komunikimi dhe bashkëpunimi në mes të grave deputete në Parlament dhe grave politikanë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në nivelin lokal është rritur, siç shihet në iniciativat në vijim.

RrGGK ka Organizuar Debate Komunale për Gratë dhe Vendim-marrjen

Me 29 mars RrGGK organizoi një debat gjatë të cilit 27 gra nga shtatë kuvendet komunale dhe organizatat anëtare të RrGGK krijuan strategji për pjesëmarrje më të madhe të grave në zgjedhjet e ardhshme komunale. Vjosa Dobruna, një aktiviste për të drejtat e njeriut dhe anëtare e Bordit Këshilldhënës të RrGGK-së moderoi debatin. Pjesëmarrëset gjeneruan ide për rritjen e numrit të grave në kuvendet komunale dhe në pozita udhëheqëse në nivel komunal. “Ky takim hap diskutimet për fuqizimin e grave, obligim dhe mandat i RrGGK” tha Vjosa Dobruna. Takimi shërbeu gjithashtu për të inkurajuar më shumë gra për tu kandiduar për kryetare të komunës. Pjesëmarrëset diskutuan cilat cilësi duhet të kenë kandidatet femra: ato duhet të jenë feministe, të kenë një qasje të ndryshme nga burrat, të jenë



aktive në shoqëri dhe të kenë vullnetin politik për të promovuar barazinë gjinore. “Unë e vlerësoj këtë nismë të guximshme dhe mendoj se ne të gjitha mund të kontribuojmë në mënyrë të vazhdueshme në këtë fushë” tha Violeta Dema, një përfaqësuese e Kuvendit Komunal të Gjakovës.

Punëtoria dukshëm fuqizoi gratë që të inkurajojnë gra të tjera që të kandidojnë për poste. Pjesërisht si rezultat i kësaj, por edhe duke u mbështetur në përpjekjet e mëparshme të vazhdueshme për fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në politikë, nëntë gra kandiduan për kryetare komunash në shtatë komuna: Gjakovë (dy), Istog (dy), Prishtinë, Skënderaj, Kaçanik, Gjiilan dhe Mitrovicë Veriore. Kjo shënon rekord pasi që maksimumi i grave që kanë kandiduar ndonjëherë për kryetare komunash në zgjedhjet e mëparshme ka qenë dy.

Takime të Grupeve të Avokimit për Barazi Gjinore

GABGj bashkojnë gratë nga politika dhe gratë nga shoqëria civile në përpjekje për të avokuar për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në nivel lokal. RrGGK ka përkrahur krijimin e dy GABGj-ve të reja në Podujevë dhe Gillogovc në vitin 2013. Kështu, RrGGK ka formuar dhjetë GABGj që nga viti 2011. RrGGK vizitoi edhe komuna të tjera, si Suharekën, Vitinë dhe Vushtrrinë, ku ende jemi në proces të krijimit të GABGj-ve. Drejtoresha Ekzekutive e eRrGGK-së takoi kryetarët e komunave të Podujevës, Vushtrrisë dhe Dragashit, duke kërkuar përkrahjen e tyre. Në vitin 2014 RrGGK do të vazhdojë punën drejt krijimit të GABGj-ve në tre komuna të reja.

RrGGK u takua me anëtarë të GABGj-ve në Prizren me 18 mars, ku u përfshin 25 gra. RrGGK poashtu organizoi një takim në Prizren me GABGj-të nga Mamusha dhe Dragashi, në mënyrë që gratë nga Prizreni të mund t’i



Vjosa Dobruna, Aktiviste e të Drejtave të Njeriut dhe anëtare e Bordit Këshillues të RrGGK diskuton strategji për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë.

monitoronin dhe përkrahnin ato. Me 1 gusht, Drejtoresha e RrGGK u ftua që të trajnojë për avokim GABGj-në në Mitrovicë. GABGj-të nga Dragashi, Prizreni dhe Mamusha u takuan sërisht me 24 shtator, duke organizuar një takim të përbashkët për të diskutuar zgjedhjet lokale. Gjatë këtij takimi ato inkurajuan gratë që të kandidojnë për pozita në asamblatë komunale. Pas takimit të përbashkët, rreth 35 gra u takuan me kryetarin e Komunës së Dragashit, për të diskutuar përkrahjen e mëtutjeshme të pjesëmarrjes së grave në asamblatë komunale.

Bresana njihet si fshati më i madh i regjinoit të Opojë. Pasi që Opoja ka komunitet shumë patriarkal, politikanët lokal të Dragashit sygjëruan një vizitë të përbashkët në Bresanë (Opojë) për të inkurajuan gratë që të jenë aktive në politikë. Me 26 shtator, rreth 25 gra, shumica prej tyre të reja, të shkolluara, u mbledhën në Bresanë për të diskutuar mundësitë për përkrahjen e aktivizmit politik.

Mitrovica është ndër qytetet që befasoi shumë njerëz duke zgjedhur një parti të re politike në pushtet. Partia paraprake kishte qenë në pushtet për më shumë se një dekadë. Kandidati i partisë politike AKR u zgjodh kryetar komune i Mitrovicës Jugore. Prandaj, Asambleja Komunale nuk do të vazhdojë të përfshijë disa nga anëtarët e GABGj-së ekzistuese. Me 7 nëntor, 13 anëtarë të GABGj vazhdimisht u takuan me Drejtoreshën e RrGGK-së për të diskutuar strategjitë lidhur me atë se si të vazhdojnë të jenë anëtarë të GABGj, duke i përcjellur njohuritë dhe përvojën e tyre tek anëtarët e përzgjedhur rishtazi.

Mentorimi

Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së ofroi 180 sesione mentoruese për anëtarët e GABGj-ve, duke përfshirë gra nga shoqëria civile dhe politika. Mentorimi u ofrua fillimisht përmes bisedave telefonike, por edhe drejtëpërdrejtë. Për shembull, ajo mentoroi Zyrтарin Komunal për Barazi Gjinore në Mamushë lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e këtyre përfaqësuesve të qeverisë, si dhe teknikat për realizimin e rolit të saj në praktikë. Në Prizren, ajo këshilloi një përfaqësues të OSHC lidhur me strategjitë për tejkalimin e ndasive politike brenda GABGj-së së tyre. Disa anëtarë të GABGj-ve thirrën për këshillë lidhur me atë se si të ngrisin çështje me përfaqësues të institucioneve të KB



që vizitonin komunat e tyre, si dhe për strategji avokuese. Për shembull, ajo ofroi këshillë për anëtarët e GABGj-ve që organizonin takime qeveritare për përkujdesin shëndetësor dhe Ligjin e Punës (në Gjakovë dhe Prizren). Ajo poashtu u ofroi përkrahje morale anëtarëve të GABGj-ve.

Mbështeten Grupet e Avokimit për Barazi Gjinore që të avokojnë për prioritetet e grave

Me 19 shtator, Drejtoresha e RrGGK dhe GABGj në Dragash u takuan me kryetarin e Komunës së Dragashit për të avokuar për ndërtimin e një kopshti për fëmijë në Dragash. Gjatë takimeve paraprake, gratë kishin shprehur nevojën për të pasur një kopsht fëmijësh në Dragash. Me 20 nëntor, drejtoresha e RrGGK organizoi një vizitë nga Presidentja Jahjaga në Gillogovc (Drenas). Për dy orë ajo dëgjoi çështjet e ngritura nga gratë që përjetuan abuzim seksual gjatë luftës. Pas këtij takimi, Drejtoresha e RrGGK-së u ftua në baza javore në Zyren e Presidentes për të diskutuar se si Presidentja mund të mbështesë sa më mirë gratë që ishin abuzuar seksualisht gjatë luftës. Bazuar në këto konsultime, Presidentja, me 7 mars 2014 krijoi komitetin ndër-ministror për adresimin e kësaj çështje.

Organizohen takime në mes të grave në politikë, OJQ-ve dhe grave votuese

Dy ditë para zgjedhjeve lokale me 1 nëntor, Drejtoresha e RrGGK-së vizitoi GABGj-në në Suharekë ku ishte organizuar një takim në mes të grave kandidate për asamblenë komunale dhe grave votuese. RrGGK poashtu organizoi takime në mes të grave votuese dhe grave kandidate në tre komuna. GABGj-të në mënyrë të pavarur organizuan shumë takime në komunat e tyre, duke punuar drejt fuqizimit të grave për të votuar për gratë. Si rezultat i kësaj, më shumë gra morrën vota nga qytetarët më shumë se çdo herë tjetër gjatë zgjedhjeve.



Më shumë gra të zgjedhura dhe të emëruara në nivel komunal dhe qendror

Pjesërisht si rezultat i çasjes aktive të GABGj-ve tek votuesit, duke i inkurajuar ata që të votojnë për gratë në zgjedhjet komunale të nëntorit, më shumë gra se çdo herë tjetër në Kosovë kandiduan për pozitën e kryetares së komunës. Mimoza Kusari-Lila u bë kryetarja e parë e një komune e zgjedhur ndonjëherë (në Komunën e Gjakovës). Më tutje, rreth 51 gra u zgjodhën në pozita të ndryshme në asamblетë komunale (dhe nuk i fituan postet e tyre falë kuotës), krahasuar me 16 në vitin 2007.¹ Kjo do të thotë një rritje në pjesëmarrjen e grave në asamblетë komunale përafërsisht nga 30% në 34%.² Më shumë gra kandiduan për kryetare komunash se çdo herë më parë dhe Mimoza Kusari – Lila u zgjodh kryetarja e parë e një komune në Kosovë (në Gjakovë me partinë e AKR-së).



RrGGK takon kryetaren e re të Komunës së Gjakovës, Zn. Mimoza Kusari – Lila, gruan e parë kryetare të një komune në Kosovë, me 20 janar.

¹ Vlerësim i RrGGK-së i bazuar në shënime zyrtare. Megjithatë, informatat zyrtare do të publikohen në mars 2014.

² Llogaritja e bër nga KIPRED, korespondenca me RrGGK-në, janar 2014.

Gratë më aktive në proceset e vendim-marrjes lidhur me paqen dhe sigurinë **Avokimi për një Plan Kombëtarë të Veprimit për implementimin e RKS KB 1325 në Kosovë**

Duke pasuar avokimin e RrGGK-së në vitet e kaluara, në vitin 2013 grupi punues për hartimin e Planit Kombëtarë të Veprimit për implementimin e RKS KB 1325 në Kosovë bëri progres në hartimin e këtij plani, i cili u aprovua në vitin 2014. RrGGK mori pjesë në këtë grup punues ndër-sektorial. RrGGK poashtu rishikoi draftin e planit dhe ofroi komente të shkruara të detajuara për të tek Agjencioni për Barazi Gjinore dhe UN Women (që asistuan me procesin e draftimit).

Më tutje, RrGGK avokoi për implementimin e RKS KB 1325 në Kosovë. RrGGK vazhdoi të avokoi për të drejtat e personave që kanë vuajtur dhunë seksuale gjatë luftës. Kjo përfshiu një numër takimesh me gra që kanë vuajtur dhunë seksuale për të dëgjuar shqetësimet e tyre. Një nga shqetësimet kryesore të ngritura ishte mungesa e çasjes në shërbime shëndetësore kualitative. Ata poashtu shprehën shqetësimin se shumë organizata, institucione dhe donatorë u takuan me ta, por që këto takime shërbyen më shumë për përfitimin e të tjerëve se sa për të përmirësuar kualitetin e tyre të jetës apo për të adresuar shqetësimet e tyre. RrGGK ka përkrahur ata në ngritjen e shqetësimeve të tyre tek nivelet më të larta të vendim-marrjes në Kosovë dhe më gjërë.

Avokim për implementimin e RKS KB 1325 nga institucionet ndërkombëtare në Kosovë

RrGGK ka kontribuar në një nismë më të gjerë kërkimore në monitorimin e zbatimit të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ([RKS KB 1325](#)) për Gratë, Paqën dhe Sigurinë të publikuar nga Zyra Ndërlidhëse Evropiane për Ndërtimin e Paqës (EPLO) në dhjetor 2013.

Pas ushtrimit paraprak të monitorimit siç është 1325 Fakte dhe Fabula, rasti studiomor i fundit nga RrGGK ka bërë të ditur që Kosova ka arritur “përparim të dukshëm” që nga viti 2010.



RrGGK poashtu u takua me Përfaqësuesen Speciale të NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Mari Skåre (në zyrën e RrGGK me 17 prill). Ajo ka promovuar publikimin e RrGGK: 1325 Fakte & Fabula, duke u kërkuar përfaqësuesve të tjerë të NATO-s, duke përfshirë edhe KFOR-in, që ta lexojnë librin.

Më pas, me 25 prill, një delegacion i RrGGK informoi Grupin Punues të OJQ-ve për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në OKB për të kaluarën dhe të tashmen e avokimeve të RrGGK-së për zbatimin e Rezolutës 1325 të KSKB-së në Kosovë. Kjo përfshinte avokimin e RrGGK-së për drejtësi për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. RrGGK shpërndau kopje të 1325 Fakte & Fabula anëtareve të Grupit Punues. Gjykata Ndërkombëtare në Hagë kërkoi gjithashtu një kopje të librit 1325 Fakte & Fabula për bibliotekën e saj.

“Shpresoj që do t’i realizoni ndryshimet që i keni arritur në ngritjen e pjesëmarrjes së grave në paqe dhe siguri përmes avokimit me 1325”.

- Përfaqësuesja Speciale Skåre, gjatë takimit me RrGGK

Avokime tjera të RrGGK

RrGGK u takua me partitë politike LDK, AAK dhe VV për të avokuar që më shumë gra të përzgjidhen në pozita vendim-marrëse. RrGGK poashtu avokoi që zërat e grave të dëgjohen për çështje të rëndësishme politike, duke shkruar letra dhe kumtesa për shtyp. Në vitin 2013, RrGGK ka shkruar katër letra 19 zyrtarve të ndryshëm për çështje me rëndësi për gra (dhe burra) në Kosovë. Këto përfshinin:

- 1) Letër drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Ban Ki Mun për këngën nacionaliste “Marš na Drinu”, të cilën Vuk Jeremiq, Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e performoj në Kombet e Bashkuara, gjatë një pritjeje zyrtare të organizuar më 14 janar 2013 (21 janar)
- 2) Letër Shefit të Zyrës BE-së në Kosovë/EUSR, Shefit të Misionit të EULEX-it, ambasadave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë dhe Italisë, të nënshkruar nga 34 OJQ-të e Kosovës, duke kërkuar që Projektligji për amnisti të rishqyrtohet dhe të mos miratohet (4 korrik)



- 3) Letër për Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale; Hashim Thaçit, Kryeministër i Kosovës; dhe Edona Hajrullahut, Kryeshefe Ekzekutive në Agjensionin për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit në lidhje me iniciativën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për punësimin e kosovarëve në Katar dhe abuzimi i mundshëm i punëtorëve sipas rregullave të shtetit pranues (9 shtator)
- 4) Letër Atifete Jahjagës, Presidente e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçit, Kryeministër i Republikës së Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Financave, Agjencisë për Barazi Gjinore, Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisionit të Pavarur për Media, dhe Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës në lidhje me Deklaratën e femnisteve të reja, të hartuar gjatë Forumit Rajonal të Femnisteve të Reja 2013 (25 nëntor)

Më tutje, RrGGK ka dërguar 14 kumtesa për shtyp në vitin 2013, 10 prej t ë cilave lidhen me përpjekjet për avokim:

- 1) Me 8 mars, lidhur me aksionin në rrugë: Shpëto jetë - Dhuro Gjak (7 mars)
- 2) RrGGK dënon kërcënimet ndaj aktivistes për të drejtat e njeriut, Nazlie Bala (21 mars)
- 3) RrGGK dënon sulmet fizike kundër aktivistes për të drejtat e njeriut Nazlie Bala (28 mars)
- 4) RrGGK reagon kundër urrejtjes dhe diskriminimit (4 qershor)
- 5) Premiera e dokumentarit “Sikur të mund të vallëzonim” (7 qershor)
- 6) Reagim kundër keqtrajtimit të gazetares Salie Gajtani (10 qershor)
- 7) RrGGK reagon ndaj projektligjit për Amnistinë (4 korrik)
- 8) 34 OJQ-të e Kosovës shkruan një letër për Zyrën e BE-së në Kosovë, EULEX-in dhe ambasadat e Kuintit duke kërkuar që Projektligji për amnisti të rishqyrtohet dhe mos të miratohet ashtu siç është (4 korrik)



RrGGK organizon një Aksion në Rrugë si pjesë e Forumit Rajonal të Femnisteve të Reja 2013 me 13 nëntor.

- 9) RrGGK uron xhudisten Majlinda Kelmendi Kampione e Botës (3 shtator)
- 10) RrGGK dënon kërcënimet ndaj Valdete Dakës (28 shtator)
- 11) RrGGK organizon Forumin Rajonal të Feministëve të Reja 2013 (12 nëntor)
- 12) RrGGK organizon aksionin në rrugë si pjesë e Forumit Rajonal të Feministëve të Reja 2013 (13 nëntor)
- 13) RrGGK dhe Alter Habitus publikojnë raportin “Ku janë paratë për të drejtat e grave?” (20 nëntor)
- 14) Feministet e reja prezantojnë deklaratën e tyre Presidentes, Kryeministrit dhe zyrtarëve tjerë qeveritar të Kosovës (25 nëntor)

Të gjitha letrat dhe deklaratat për shtyp janë në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK.

Politikat publike të ndryshuara për të pasqyruar prioritetet e grave votuese

Gjatë vitit 2013, RrGGK ka informata që deri më tani së paku katër politika janë ndryshuar si rezultat i iniciativave avokuese të anëtareve të RrGGK. Së pari, Shoqata e Personave të Shurdhër në Prizren ka avokuar me sukses që Komuna e Prizrenit të punësojë një interpretues/përkthyes që të ofroj prkthim/interpretim për personat e shurdhër. Së dyti, FEZH, një grup i grave kryefamiljare nga Novobërda ishin u përfshinë në planin e buxhetit komunal. Së treti, ird, *Gruaja Hyjnore* avokoi me sukses tek Kryetari i Komunës së Gjilanit për të siguruar një hapësirë për zyret e OJQ-së së tyre.

Në nivelin kombëtar, RrGGK vazhdon të kontribuojë në procesin e krijimit të grupit zyrtarë punues për të drejtat e personave LGBT në Zyrën për Qeverisje të Mirë, Mundësi të Barabarta dhe Çshtjet Gjimore, brenda Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. RrGGK poashtu vazhdoi avokimin e vet lidhur me amandamentimin e Ligjit No. 04/L-054 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, për përfshirjen e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Si rezultat, është formuar një Këshill është formuar në nivelin e Presidentes me qëllim që të kërkojë drejtësi dhe përkujdesje të duhur, holistike për gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës, shumë prej të cilave vazhdojnë të jetojnë në kushte të vështira.

PËRMIRËSIMI I QASJES SË GRAVE NË KUJDES CILËSOR SHËNDETËSOR

Për objektivin e tretë afatgjatë, RrGGK ka për qëllim që “gratë të kenë qasje të përballueshme dhe cilësore në kujdesin shëndetësor”. Objektiva kryesore afatshkurtër është të përmirësojë qasjen e grave në shërbime shëndetësore kualitative. Për fat të keq, përkundër përpjekjeve të shumta, RrGGK nuk ka qenë në gjendje që të sigurojë fonde për punën e saj në këtë drejtim. RrGGK ka kërkuar fonde përsëri për vitin 2014. Edhe kështu, në sajë të punës së madhe të anëtareve të RrGGK, është bërë një progres i Fondit të Grave të Kosovës drejt arritjes së këtyre rezultateve të pritura.

Më shumë gra dhe vajza të vetëdijshme për të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

Grantet e siguruara nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës mbështesin përpjekjet e shumta për të avancuar njohuritë e grave dhe qasjen në kujdesin cilësor shëndetësor. Anëtarët që kanë përfituar grante për të punuar drejt këtyre rezultateve janë:

- Qendra e Grave “Prehja” organizoi leksione për të rritur vetëdijësimin në lidhje me kancerin e gjirit në katër fshatra të Skenderajt, ku morën pjesë afro 200 gra. Ato gjithashtu organizuan takime me gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit.
- Shoqata e të Shurdhërve në Prizren organizoi vizita sistematike gjinekologjike dhe trajnime shëndetësore për gratë e shurdhëra.



- OJQ Lulebora nga Prishtina në kuadër të projektit të tyre “Unë dua të jem e shëndetshme” ka ofruar këshillime gjinekologjike për gratë dhe vajzat roma në Mitrovicë.
- Foleja edukoi gratë dhe vajzat roma, ashkali dhe egjiptase për të drejtat e tyre shëndetësore në Prizren, Landovicë, Piranë, Skenderajin jugor dhe Mamushë.
- Bliri ka ngritur vetëdijen për shëndetin riprodhues në mesin e vajzave në Drenas.

Në total, 673 gra dhe vajza morën pjesë në takime, diskutime dhe trajnime që ngriten vetëdijësimin e tyre në tema të lidhura me shëndetin. Prej tyre, 91 gra përfituan nga vizitat dhe testet gjinekologjike.

Më shumë gra të vetëdijësuar se si të zbulojnë shenjat e kancerit

Për të gjashtë herë me rradhë, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta-Vita, anëtare e RrGGK, mbledhi qytetarët para Teatrit Kombëtar, me 12 tetor. Pas një programi informativ dhe kulturor marshuan së bashku në shesh me moton: “Zbulimi i hershëm = Mbijetesë”. Këtë vit, duke u bazuar në sukseset e mëparshme, Jeta-Vita kërkoi bashkëpunim më të mirë me institucionet e Kosovës në diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit.

Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e mbështeti këtë nismë. “Kërkoj nga nënat, motrat, bijat që të bëjnë kontrollin mjekësor, sepse zbulimi i hershëm do të thotë fitore mbi kancerin e gjirit,” tha ajo. “Me këtë ecje tonë simbolike ne promovojmë mirësinë dhe solidaritetin tonë si individ, si shoqëri dhe si institucione për të gjitha ato që vuajnë nga kanceri i gjirit. Së bashku mund ta fitojmë këtë betejë.” Përfaqësues të tjerë të nivelit të lartë të shtetit poashtu shprehën solidaritet për njerëzit që vuajnë nga kanceri i gjirit., duke ofruar mbështetjen e tyre.

“Ne nuk kërkojmë mëshirë, nuk kërkojmë diçka të pamundur, kërkojmë vetëm trajtim cilësor për zbulimin e hershëm dhe trajtimin e kancerit të gjirit. Kjo sëmundje nuk i prek vetëm femrat, por gjithë shoqërinë.”

- Nafije Latifi, drejtoreshë ekzekutive e Jeta-Vita.

Dhuro Jetë: Dhuro Gjak, RrGGK shënon 8 Marsin

Anëtarët e RrGGK vendosën që avokimi i RrGGK-së në Ditën Ndërkombëtare të Gruas këtë vit do të fokusohet në çasjen e grave në shërbime shëndetësore kualitative. Mbështetur nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ), RrGGK shënoi 8 Marsin me një aksion në rrugë “Dhuro Jetë: Dhuro Gjak.” Qytetarët u ftuan që të dhurojnë gjak (në vend të dhurimit të luleve), duke ndihmuar sistemin e dobët shëndetësorë të Kosovës. Në total, 37 burra dhe gra dhuruan gjak në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë.

“Pasi që gjendja ime shëndetësore dhe mosha nuk më lejon të dhurojë gjak, kam sjellur me vete sot dy djemtë e mi. Ata mund të dhurojnë gjak dhe të ndihmojnë gratë kosovare”

– Fatima Zatriqi nga Mitrovica Veriore



RrGGK, e mbështetur nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut (QKTGJ), shënoi Ditën Ndërkombëtare të gruas përmes aksionit në rrugë “Dhuro Jetë: Dhuro Gjak”.

JETA PA DHUNË NË FAMILJE DHE PA TRAFIKIM

Duke pasur parasysh përpjekjet e mëparshme të RrGGK në këtë drejtim, rrjeti u përqendrua më shumë në çështjet e tjera të lartpërmendura për zbatimin e strategjisë brenda këtij viti. Megjithatë, disa veprime janë marrë në drejtim të rezultateve të pritura si në vijim.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me legjislacionin, përfshirë edhe burrat Avokuan për implementimin e mëtutjeshëm të Ligjit dhe Strategjisë për Dhunë në Familje

Që nga adoptimi i “Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014”, RrGGK ka avokuar tek zyrtarët për caktimin e Koordinatorit Kombëtarë siç ishte paraparë. Më në fund, kah fundi i vitit 2012, u caktua Zëvendës Ministri i Drejtësisë, Z. Daut Xhemajli. Në vitin 2013, ai koordinoi takime tremujore me të gjitha palët e interesuara dhe diskutoi sfidat dhe rezultatet drejt implementimit të Programit të Kosovës. RrGGK morri pjesë në këto takime dhe koordinatori ishte i kënaqur që pranoi hulumtime dhe informata të tjera nga RrGGK, bazuar në përvojën e RrGGK. RrGGK poashtu ndau *Ku Janë Paratë për të Drejtat e Grave?* me koordinatoren dhe të gjitha palët e interesuara.

Kosova bashkohet me “One Billion Rising”

Me 14 shkurt, Kosova u bashkua me 207 vende të botës, duke shënuar ditën-V me veprimin më të madh global në histori për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave. Për të shënuar 15 vjetorin e ditës-V, organizatorët kanë nisur fushatën më ambicioze të ditës-V deri më sot, “One billion Rising”. “One billion” rrjedh nga statistika se një e treta grua përjeton dhunë në jetën e tyre dhe në këtë mënyrë më shumë se një miliardë grua në mbarë botën kanë vuajtur



– Fitore, pjesëmarrëse në “One Billion Rising”

– Fitore, pjesëmarrëse në “One Billion Rising”

A group of young women are protesting in a city square. They are holding various signs and banners. One sign says "Kërkojme Drejtësi" (We demand justice). Another says "STOP VIOLENCE against WOMEN and GIRLS". A third says "MJAFT/STOP DHUNËS" (Enough/Stop violence). A fourth says "ONE BILLION RISING". A fifth says "Say NO TO VIOLENCE against Women and GIRLS!". There are also red heart-shaped signs. The women are dressed in winter clothing. The background shows city buildings and streetlights.

43



MBËSHTETJA PËR FUQIZIMIN EKONOMIK TË GRAVE

Objekti afatgjatë i këtij programi është që gratë të kenë qasje të barabartë në mundësitë e punësimit në Kosovë. Objektivat afatshkurtra janë për përmirësimin e pozitës ekonomike të grave në Kosovë dhe për të përmirësuar qasjen e grave në pronë (dhe si rrjedhojë në kapital), në përputhje me të drejtat e tyre ligjore. Në vitin 2013, RrGGK arriti rezultatet si në vijim.

Fuqizohet grupi punues brenda RrGGK-së

Mblidhet Grupi i Fuqizimit Ekonomik

Me 6 mars, RrGGK ka organizuar një punëtori me grupin punues për fuqizimin ekonomik të grave. Punëtorja kishte dy sesione: Fuqizimin ekonomik të grave përmes gjenerimit të të ardhurave dhe Të drejtat e grave në trashëgimi dhe pronë. Seanca e parë ishte ndjekur nga 21 përfaqësues të RrGGK-së, ndërkaq seanca e dytë përfshi u shtatë organizata. Anëtarët ndanë informata lidhur me iniciativat e tyre dhe diskutuan strategji potenciale të përbashkëta për të ardhmen.

Pas këtij takimi, RrGGK poashtu u takua me Global Goods në New York, një organizatë jo-profitabile që mbështetë gratë në tregtimin e produkteve të tyre në SHBA, për të diskutuar çfarë hapa do të duhet të ndërmarrin gratë në Kosovë që të mund të shesin produktet e tyre jashtë vendit. Takimi solli si përfundim se gratë në Kosovë kanë shumë punë përpara për të arritur çasjen në tregun në SHBA, veçanërisht lidhur me zhvillimin e produkteve.



Anëtarët e RrGGK-së diskutojnë dhe ndajnë përvojat e tyre lidhur me fuqizimin ekonomik të grave.



Shumë Gra Zhvillojnë dhe Menaxhojnë Biznese të suksesshme

Përmes Fondit të Grave të Kosovës dhjetë organizata anëtare të RrGGK-së pranuën përkrahje për punën e tyre lidhur me fuqizimin ekonomik të grave: Ikebana, FEZH, Krusha e Vogël, *Gruaja Hyjnore*, *Parajsa Jonë*, *Rikotta*, *Rona*, Iniciativa e Grave, *Gora* dhe *Alma*. Katër prej këtyre organizatave trajnuan 223 gra për të zhvilluar bizneset e tyre. Për shembull, FEZH trajnoi gratë se si të përgatisin ushqim dhe ta shesin atë tek turistët, si të krijojnë punëdore dhe si të përgatisin bimë mjekësore. *Krusha e Vogël* Shoqata e Grave Fermere i trajnoi gratë se si të rrisin përfitimet e tyre duke rritur kualitetin e qumështit dhe afatin e tij të përdorimit. *Gruaja Hyjnore* trajnoi gratë në preatitjen e produkteve të punëdore. *Parajsa Jonë* trajnoi gratë për të rritur fidane të cilat pastaj mund t'i shesin.

Pas reflektimit në punën e RrGGK-së në këtë fushë deri më sot dhe analizimin e situatës, anëtares e RrGGK-së kanë vendosur që të mos vazhdojnë aktivitetet lidhur me zhvillimin e bizneseve sepse ato nuk janë mjaftueshëm të lidhura me misionin dhe vizionin e RrGGK-së. Në të ardhmen, RrGGK do të fokusohet më shumë në avokim dhe politika. Ky

vendim u bazua në faktin se tani në Kosovë egzistojnë disa programe që përkrahin gratë në zhvillimin e bizneseve të tyre. Më tutje, Oda e re Ekonomike e Grave poashtu do të fokusohet në këto çështje. RrGGK planifikon të përkrahë punën e saj, në vend se të jetë direkt e përfshirë në implementimin e aktiviteteve të tilla në të ardhmen.



Agim Gashi, Drejtor i Departamentit të SHërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pren tortën e bërë nga anëtare të OJQ Rikotta, duke hapur zyrtarisht "Tregun e Grave".



Sylbije Sahiti nga Parajsa Jonë flet për higjienën e ushqimit.

Shumë vajza ndjekin nivelet më të larta të arsimit

Gjatë Forumit Rajonal të Feministëve të Reja 2013, një nga pikat kryesore të ngritura nga Presidentja e Kosovës dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ishte që ata të bëjnë të gjitha brenda fuqive të tyre për të siguruar që sa më shumë vajza të kenë qasje në nivelet më të larta të arsimit. Feministet e reja rekomanduan që kjo Ministri, Ministria e Financave dhe Parlamenti të sigurojë libra dhe transport për vajzat, veçanërisht në qoftë se familjet e tyre nuk mund të përballojnë shpenzimet për shkollimin e tyre për shkak të kufizimeve financiare. Feministet e reja poashtu kërkuan nga qeveria që të zbatohet Ligji për Arsimin Parauniversitar, i cili kërkon nga prindërit që ti dërgojnë fëmijët në shkollë. Ato gjithashtu bënë thirrje për psikologët në shkolla për të ndihmuar vajzat e reja në tejkalimin e sfidave që mund ti ndalojnë ato për të vazhduar shkollimin.

Fondacioni “Çifti Buçinca” pranon Kontributin Jetësor të çiftit në Shkollimin e Vajzave

Një mbrëmje Gala shënoi krijimin e fondacionit “Çifti Buçinca” për arsimimin e vajzave me 23 maj. Për më shumë se 60 vjet, Naxhie dhe Fahri Buçinca kanë punuar për arsimin formal dhe joformal me vajzat e reja. Tani në moshën 80 vjeçare, fondacioni “Çifti Buçinca” u krijua për të vazhduar kontributin e tyre duke u mundësuar vajzave qasje në arsim për vitet që vijnë. Mbrëmja gala ka mbledhur shumën prej 23,969€ për fondacionin “Çifti Buçinca”, kryesisht nga bizneset lokale, organizatat dhe individët. RrGGK gjithashtu ka nderuar kontributin e Buçincave me një certifikatë mirënjohjeje. RrGGK gjithashtu ofroi një donacion prej 1,000€ për Fondacionin “Çifti Buçinca”.



INICIATIVA TË RËNDËSISHME...

Historitë Gojore

RrGGK në bashkëpunim me Universitetin “New School” të Nju Jorkut filloi një nismë të re për të dokumentuar historitë jetësore të njerëzve të ndryshëm në Kosovë. Iniciativa e historisë gojore bashkon tregimet jetësore të njerëzve nga vende dhe kohë të ndryshme, duke dokumentuar historitë e tyre, në mënyrë që ata të mbesin në histori.

Në vitin 2013, historia gojore kolektive ka realizuar 15 intervista me aktivistë të ndryshëm, duke përfshirë këtu aktivistët Vjosa Dobruna, Vehap Shita, Shqipe Malushi, Marte Prenkpalaj, Safete Rogova, Pajazit Nushi, Naxhiye Buçinca, Sevdije Ahmeti, Jalldëze Gorani, Elmaze Gashi, Nazlie Bala dhe Drita Vukshinaj. Intervista të tjera do të zhvillohen në të ardhmen. Këtë vit, historitë e tyre dhe të tjerëve do të jenë publikisht në dispozicion nëpërmjet ueb faqeve kërkimore, interaktive, multi-mediale. Faqja e internetit do të përmbajë pamjet e papërpunuara të intervistave, transkriptat në shqip dhe anglisht, fotografi historike dhe filma të shkurtër.

Nisma gjithashtu përfshin dokumentimin e jetës së grave që morën pjesë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Është e rëndësishme për ta kuptuar rolin e grave në luftën e viteve 1998-1999 për shkak të mungesës së njohjes publike për këtë grup të veçantë, dhe më pas mungesën e tyre në ndërtimin e vendit pas pavarësisë. Që nga gushti 2012, gjashtë gra kanë shpalosur historitë e tyre. Këtë vit janë bërë transkriptat e intervistave të tyre dhe janë përkthyer në anglisht. E frymëzuar nga intervistat e tyre, Virginia Stephens, kandidate për doktoraturë, shkroi një letër në lidhje me gratë në UÇK, e cila u prezentua në konferencën vjetore 2013 në qendrën për kulturë dhe studime kulturore “Memoare kulturore” nga 5-7 shtator në Shkup, Maqedoni. Iniciativa e historisë gojore është mbështetur nga Universiteti “New School”, veçanërisht nga Dr Anna Di Lellio, Kaltrina Krasniqi regjisorë e filmit, Virginia Stephens kandidate për doktoraturë nga Universiteti Goldsmiths, Catherine McGahan dhe Jung Chao nga New School dhe shumë gra të tjera aktiviste, hulumtues dhe përkthyes të cilët kanë dalë vullnetarisht duke ofruar kohën e tyre për këtë iniciativë të rëndësishme (ju lutem shihni vullnetarët më poshtë).




Mbulimi mediatik dhe Aktivitetet në Internet

Për vite të tëra, RrGGK ka bashkëpunuar me media në nivel lokal dhe kombëtarë, duke avokuar që ato të ofrojnë më shumë hapësirë për gratë. Gjatë zgjedhjeve të kaluara, mediat kërkonin që të paguheshin për të përfshirë mbulimin mediatik të grave kandidatë. Pas shumë vitesh avokimi nga RrGGK, në mesin e të tjerëve gratë politike, besojnë që përpjekjet tona avokuese kanë rezultuar në ndryshime në mënyrën se si mediat bëjnë mbulimin e zgjedhjeve. Për herë të parë, gjatë zgjedhjeve lokale, disa gra kandidatë kishin mbulim mediatik qenësor pa pagesë. Ndoshta programi më i suksesshëm kombëtarë në promovimin e kandidatëve burra dhe gra ishte *Jeta në Kosovë*. Vet RrGGK kishte së paku 55 raste të mbulimit mediatik në vitin 2013, duke përfshirë televizionet, mediat e shkruara dhe ato online.

RrGGK vuri në funksion faqen e saj të përditësuar të internetit (www.womensnetwork.org) në të tre gjuhët. Faqja e re e internetit është më interaktive, përmban më shumë informata për historinë e RrGGK, që nuk ishte publikuar ndonjëherë më herët në faqen e internetit dhe ka këto seksione të reja: Seksioni “Anëtarët” përmban informata në lidhje me secilën prej organizatave të ndryshme anëtare, të renditura sipas alfabetit, komunës dhe fushave të ekspertizës (p.sh. ekonomi, shëndetësi etj). Seksioni i ri i Anëtarëve Individual mundëson që individët t’i [bashkangjiten RrGGK-së](#) duke kompletuar një formular të anëtarësimit online. Anëtarët Individual tani poashtu listohen tek “[Anëtarët Individual](#)”. Seksioni “[Fondi i Grave të Kosovës](#)” ofron informata lidhur me programin tonë të granteve, duke përfshirë suksesin e përfituesve të granteve deri në kohën aktuale dhe mënyrën se si të aplikohet. Seksioni i “[Burimeve](#)” lehtëson qasjen në hulumtimet dhe publikimet, të reja dhe të vjetrat, në lidhje me barazinë gjinore, gratë në politikë, gratë dhe ekonomia, gratë dhe shëndetësia, dhunës në familje dhe trafikimit në Kosovë, duke lehtësuar qasjen në informata që ndonjëherë janë vështirë për t’u gjetur. Seksioni “[Media](#)” përfshin mbulimin e shtypit, komunikata për shtyp dhe video të RrGGK. Koordinatorja për Marrëdhënie me Publikun është përgjegjëse për përditësimin e rregullt të faqes së internetit të RrGGK-së dhe [Faqes së Facebook-ut](#) me informata për secilën ngjarje, mënjëherë posa ajo të ketë ndodhur.



Faqja e Facebook-ut të RrGGK-së kishte 1,285 përcjellës (folloëers) (që e “pëlqejnë” atë) deri me datën 31 dhjetor. (2,190 deri me 31 janar), një rritje e dukshme krahasuar me vitet e kaluara. RrGGK përfitoi shumë përcjellës të rinj me 13-14 nëntor, gjatë Forumit Rajonal të Feministëve të Reaja 2013. Prioritet tregojnë që adhuresit e RrGGK-së janë gra, edhe pse 17% janë burra. Shumë prej tyre i takojnë grupmoshës 18-34 vjeç (shikoni Grafikun 1). Ndërkaq, grupi i Facebook-ut të Iniciativës për Fuqizimin e Vajzave të RrGGK-së është rritur deri në 327 anëtarë. Këtë vit RrGGK vendosi që të mbyllë të dy grupet e veta të Facebook-ut, duke iu kërkuar të gjithë anëtarëve që të “pëlqejnë” faqet në vend të tyre. Ky vendim erdhi pas kërkesës së palëve të interesuara që të lehtësojmë postimet e tyre pa nevojën e aprovimit të tyre.




Grafiku 1. Ndjekësit e RrGGK në Facebook në vitin 2013 sipas moshës dhe gjinisë.

RAPORTI FINACIAR I RRGK-SË PËR VITIN 2013

Në vitin 2013, RrGGK pranoi mbështetje financiare nga Kvinna till Kvinna (KtK), Austrian Development Agency (ADA), Association for Women in Development (AWID), Fondacioni Mott, New School University, Fondacioni IPKO, Swedish International Development Agency (Sida), Heart and Hand Foundation dhe Network of East-West Women (NEWW). Më tutje, këto biznese ofruan të mira dhe shërbime pa pagesë apo me çmime të zbritura dhe në këtë mënyrë mbështetën punën tonë: Night Design, Hotel Gorenje, Hotel Prishtina, Hotel Sirius, Hotel Dolce Vita dhe Hotel Sharr. Tabela e mëposhtme përmbledhë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet në vitin 2013.

Të hyrat e gjithëmbarshe	300,448.46	100%
Shpenzimet operacionale	77,332.38	26%
Shpenzimet e programit	115,089.46	38%
Shuma e granteve të dhëna për anëtarët e RrGGK	55,330.00	18%
Shuma për tu bartur në 2014	46,823.52	16%
Shuma e përcjellur dhe e kthyer tek donatori	5,873.10	2%



Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2012	Të pranuarat gjatë vitit 2013	Fondet në total	Shpenzimet	Iu janë dhënë anëtareve të RrGGK	Të kthyera tek donatorët	Fondet e përcjellura	Të barten për vitin 2014
Kvinna till Kvinna Suedi	Projekti për Fuqizimin e grave	25,439.00	31,890.00	57,329.00	51,524.00				5,805.00
Kvinna till Kvinna Suedi	Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave		25,482.00	25,482.00	22,984.00				2,498.00
Kvinna till Kvinna Suedi	Fondi i Grave të Kosovës	1,000.00	26,052.00	27,052.00	7,785.00	19,136.00			131.00
UNFPA	Rritja e vetëdijësimit për Mekanizmat e Barazisë Gjinore në Sektorin e Shëndetësisë në Kosovë 2012-3	3,820.00		3,820.00			3,820.00		

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2012	Të pranuarat gjatë vitit 2013	Fondet në total	Shpenzimet	Iu janë dhënë anëtareve të RrGGK	Të kthyera tek donatorët	Fondet e përcjellura	Të barten për vitin 2014
Fondacioni Mott	Përkrahje e Përgjithshme 2012-2013		18,669.76	18,669.76	18,669.76				
Ambasada e Holandës	Në kërkim të të Drejtave të Grave		2,053.10	2,053.10				2,053.10	
Association of Women in Development (AWID)	Hulumtimi: Ku janë Paratë për të Drejtat e Grave		3,717.70	3,717.70	1,200.70	2,517.00			
Austrian Development Agency	Duke Mbështetur, Mbrojtur dhe Promovuar të Drejtat dhe Interesat e Grave dhe Vajzave	140,400.00		140,400.00	77,995.90	36,194.10			26,210.00

Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2012	Të pranuar gjatë vitit 2013	Fondet në total	Shpenzimet	Iu janë dhënë anëtareve të RrGGK	Të kthyer tek donatorët	Fondet e përcjellura	Të barten për vitin 2014
Sida	Studimi Gjinor në Kosovë nga Sida		4,909.55	4,909.55	4,909.55				
U.S. Citizens	Donacione		200.00						
The New School	Iniciativa e Historisë Gojore		1,160.00						
The New School	Iniciativa e Historisë Gojore		1,363.00						
Donacionet individuale përmes East-West Management Institute (EWMI)	Iniciativa e Historisë Gojore		2,113.46						
Donacionet nga East West Women	Iniciativa e Historisë Gojore		726.00	1,990.00					
Sub-totali i Fondeve për Inicativën e Historisë Gojore				5,562.46	2,392.46				3,170.00



Donatorët	Projektet	Të bartura nga viti 2012	Të pranuar gjatë vitit 2013	Fondet në total	Shpenzimet	lu janë dhënë anëtareve të RrGGK	Të kthyer tek donatorët	Fondet e përcjellura	Të barten për vitin 2014
Revista Kosovo 2.0	Iniciativa e Historisë Gojore		700.00						
Pagesat e Anëtarësimit të OJQ-ve të RrGGK	Fondi i Qëndrueshmërisë		1,780.00						
Anëtarët Individual	Fondi i Qëndrueshmërisë		308.00						
Fondacioni Heart and Hand	Fondi i Qëndrueshmërisë		390.00						
Chantal Desloges Consulting Services	Fondi i Qëndrueshmërisë		646.50						
Donacion nga Ambasada Hollandeze	Fondi i Qëndrueshmërisë	2,310.00							

EWMI	Fondi i Qëndrueshmërisë		318.39						
Sub-totali i Fondeve për Fondin e Qëndrueshmërisë				6,452.89	4,737.33				1,715.56
Fondacioni Ipko	Mbështetje e përgjithshme fondi i grave		5,000.00	5,000.00	2,577.36				2,422.64
Total		172,969.00	127,479.46	300,448.46	194,776.06	57,847.10	3,820.00	2,053.10	41,952.20



INDEPENDENT AUDITOR'S REPORT

To: EXECUTIVE MANAGAMENT OF KOSOVO WOMENS NETWORK (KWN)
PRISHTINA

We have audited the costs and supplementary financial data of Kosova Women's Network (KWN) expresses in EUR, for the period ended December 31, 2013. We expressed an unqualified audit opinion on those financial statements in our report dated 13 March 2014.

Management's Responsibility for the Summary Financial Statements

Management is responsible for preparing financial statements and supplementary financial data. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparations and fair presentation of financial statements that are free from material misstatements, prove income and expenditure according the budget.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on the aforementioned financial information based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the reporting forms are free of material misstatement. An audit includes examining, on a test basis, evidence supporting the amounts and disclosures in the reporting forms. An audit also includes assessing the accounting principles used and significant estimates made by management, as well as evaluating the proper accounting and reporting of the data on the financial statements. We believe that our audit provides a reasonable basis for our audit opinion.

Opinion

In our opinion, the summary financial statements derived from the audited financial statements of Kosovo Women's Network (KWN) expresses in EUR, for the period ended December 31, 2013 are a fair summary of those financial statements in accordance with the International Financial Reporting Standards.

Xhemail Syla
Statutory auditor
"Sylë Hotla"#1
Pristine

13 March 2014

XHEMAIL SYLA
Auditor Ligjor
Statutory Auditor
044/156 921, Prishtinë



GRANTET E FONDIT TË GRAVE TË KOSOVËS

Gjatë vitit 2013, RrGGK ka dhënë 22 grante organizatave anëtare përmes Fondit të Grave të Kosovës.

#	Organizata	Shuma	Emri i Projektit
Raundi 2			
1	Qendra për Zhvillim Ekonomik të Grave në Shtërpce "Ikebana"	€2,707	Kultivimi i bimëve mjekësore
2	Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim (FEZH)	€2,600	Fuqizimi ekonomik i grave në Komunën e Novobërdës
3	Shoqata e grave fermere "Krusha e Vogël"	€2,390	Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale (Krushë e Vogël dhe Has – KK Prizrenit)
4	Shoqata e të Shurdhërve në Prizren	€2,514	Një grua e shëndetshme, një familje e shëndetshme
5	Qendra e Grave "Prehja"	€2,160	Të mbrojmë shëndetin tonë
6	OJQ Lulebora	€1,370	Unë dua të kujdesem për shëndetin tim
7	OJQ Gruaja Hyjnore	€2,420	Fuqizimi i grave në rajonin e Gjilanit
8	OJQ Parajsa Jonë	€2,656	Zhvillimi i aktiviteteve trajnuese dhe promovimi i tyre në hortikulturë dhe në tregti për gratë në zonat rurale të Komunës së Lipjanit
Raundi 3			
1	Rikotta	€2.990	Tregu ku do të shiten produkte të Grave
2	Rona	€2,800	Fuqizimi ekonomik i grave dhe pjesëmarrja në turizëm përmes trashëgimisë kulturore në Gorë dhe Opojë

3	Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës	€2,870	Integrimi i fëmijëve të verbër në shkolla publike në rajonin e Prishtinës
4	Venera	€2,666	Punësimi dhe vetëpunësimi me ndihmën tonë profesionale
5	Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave	€2,570	Identifikimi i rasteve të dhunimit gjatë luftës në Komunën e Drenasit
6	Bleri	€2,500	Ngritja e vetëdijes për shëndetin riprodhues te vajzat në Komunën e Drenasit
7	Foleja	€2,740	Edukimi shëndetësor dhe mbrojtja e grave dhe vajzave të komuniteteve egjiptian, roma dhe ashkali
Raundi 4			
1	Alma	€2,854	Fuqizimi ekonomik i grave në dy bashkësi lokale të Pejës
2	Gruaja Bashkëkohore	€2,155	Ndihmo sot për një të ardhme më të mirë për gratë me aftësi të kufizuara
3	Organizata e Personave me Distrofi Muskulare	€2,700	Hapi im, sfida ime
4	Shoqata Iniciativa e Grave	€3,000	Mundësi të reja në drejtim të avancimit të punësimit
5	Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes	€2,390	Sa më shumë vetëdijesim aq më pak rrezik
6	Gora	€2,780	Fuqizimi ekonomik i grave të komunitetit goran
7	Hendifer	€2,630	Grua e gëzuar, familje e shëndetshme

Donacione tjera për anëtarët e RrGGK

Artikulli	Vlera
1. Tel Mobil Samsung Galaxy fit black	€130.00
2. Tel Mobil Samsung Red	€30.00
3. DVD player	€20.00
4. CD/MP3/IPod/Sistem Zërimi	€50.00
5. Aparat Digjital	€100.00
6. Aparat Digjital	€80.00
7. USB	€40.00
8. Laptop ACER	€200.00
9. Laptop TOSHIBA	€200.00
10. Bluzë "This is what feminist looks like"	€10.00
Vlera totale e vlerësuar	€ 860.00



Një anëtare e RrGGK pranoi një bluzë me shkrimin "This is what feminist looks like," të krijuar për Forumin Rajonal të Feministeve të Reja 2013.

PËR NE

Bordi i Drejtorëve të RrGGK

Ariana Qosaj-Mustafa, Kryetare e Bordit, Aktiviste për të drejtat e grave
Elmaze Gashi, Sekretare, Drejtoreshë ekzekutive, Alter Habitus
Sevdije Ahmeti, Aktiviste për të drejtat e njeriut
Nermin Mahmuti, Drejtoreshë ekzekutive, Fondi për Zhvillim të Komunitetit
Dr Minire Bunjaku Zuna, Gjinekologe, Aktiviste për të drejtat e grave
Ola Syla, Drejtoreshë ekzekutive, Shoqata e grave “Drita e Krushës”

Bordi Këshillëdhënës i RrGGK

Delina Fico	Vjosa Dobruna
Rachel Ēareham	Marte Prekpalaj
Behar Selimi	

Anëtares e Stafit të RrGGK për vitin 2013

Igballe (Igo) Rogova, Drejtoreshë ekzekutive	Mimoza Pachuku, Kordinatore e Fondit të Grave të Kosovës
Besa Shehu, Menxhere administrative dhe e financave	Donjetë Berisha, Asistente për Marrëdhënie me Publikun
Nicole Farnsworth, Menaxhere e programit	Fjolla Vukshinaj, Kordinatore për Iniciativën e Fuqizimit të Vajzave
Zana Rudi, Kordinatore e projektit	
Nertila Qarri, Kordinatore e marrëdhënieve me publikun	
Anita Prapashtica, Asistente e projektit	



Personat që kanë punuar vullnetarisht për RrGGK

Anna Di Lellio
Blendina Krasniqi
Catherine McGahan
Dafina Tahiri
Donjeta Berisha
Eda Shehu
Emine Berisha
Erla Gjinushi
Itziar Mujika
Jung Chao
Kaltrina Krasniqi
Krenar Basha
Laureta Kozmaqi



Stafi i RrGGK përgatiten për One Billion Risingme 14 shkurt (nga e majta në të djathtë): Fjolla Vukshinaj, Nertila Qarri-Gërguri, Besa Shehu, Nicole Farnsworth, Donjeta Berisha, Zana Rudi, Igballë Rogova, Mimoza Pachuku dhe Anita Prapashtica.

ANËTARET E RRGK

#	Emri i organizatës	Adresa e zyrës	Përfaqësuesja
1	Alma	Rr. Shpëtim Bojku, Nr. 1, Pejë	Shemsije Seferi
2	Alter Habitus	Prishtinë	Eli Gashi
3	Arta	Rr. Vetërniku I, Behar Begolli, Nr.23, Prishtinë	Hafije Qyqalla
4	Artpolis	Rr. Shaban Polluzha, Pn, Prishtinë	Zana Hoxha Krasniqi
5	ATO	Rr. Wesli Clark, Pn, Vushtrri	Fikrije Ferizi
6	Aureola	Kompleksi Avalla, B/I, Nr. 4, Prishtinë	Sanije Grajçevci
7	Bleri	Drenas, Glllogoc	Mahije Smajli
8	Dera e Hapur	Tringë Smajli, Nr. 72, Prishtinë	Belgjyza Muharremi
9	Dora Dorës	Rr. Mbreti Zog, Nr. 59, Prizren	Vjosa Curri
10	Down Syndrome Kosova	Kroi i Bardhë, Nr. 72, Dardania, Prishtinë	Leonora Shabani
11	Drena	Drenas	Zymrije Qorri
12	EMINA – Grupi i Grave Boshnjake	Rr. 7 Shtatori, Jakup Ferri, Mitrovicë	Fata Zatriqi
13	FANA	Rr. Zhuj Selmani, Nr. 103, Pejë	Fane Gashi
14	Femra Vizionare e Shekullit XXI	Fsh. Bregdrini, Has, Prizren	Marte Prekpalaj
15	Femrat Aktive të Gjakovës	Rr. Sulejman Vokshi, Nr. 1, Gjakovë	Valbona Doli Rizvanolli
16	Fondacioni për Edukim dhe Zhvillim	Bregu i Diellit - Zona e Lindjes, Ll. 12, Nr. 7, Prishtinë	Vjollca Zeqiri

17	Forumi Demokratik i Gruas (FDG)	Rr. Mbretëresha Teutë, Nr. 103, Pejë	Myzafer Ibishaga
18	Gratë e Minatorëve	Suhodoll, Mitrovicë	Emine Tahiri
19	Gruaja Bashkëkohore	Rr. Bajo Topulli, Nr. 7	Fetije Mehmeti
20	Gruaja Hyjnore	Rr. Sadullah Brestovci, Gjilan	Igballe Hajdari
21	HANDIKOS, Femrat me Aftësi të Kufizuara	Dardania B 1/5, Prishtinë	Mehreme Llumnica
22	Hendifer	Rr. Ramadan Rexhepi, Nr. 1, Ferizaj	Fazile Bungu
23	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK)	Rr. Ulqinir, Nr. 74, 40.000, Mitrovicë	Magbule Hyseni
24	Kelmendi	Kelmend – Lipe	Valbona Kelmendi
25	Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës (KGVK)	Bregu i Diellit, Rr. Gazmend Zajmi, Ndërtesa e Standardit, Prishtinë	Bajramshahe Jetullahu
26	Konvita	Dolak, Vushtrri	Merita Selimi
27	Klubi i Basketit me Karroca (KBK) “Marsi”	Prizren	Nafije Gashi
28	Legjenda	Viti	Melihate Osmani
29	LIRA	Prishtinë	Valire Buza
30	Lulebora	Mentor Retkoceri, Nr. 9b, Prishtinë	Selvetë Gashi
31	Lulishtja (Garden of Floëers)	P. F. Keqekollë, Dabishevc	Sadije Dulahu
32	LUNA	Prilluzhë, Vushtrri	Stanica Kovacevic
33	Medica Kosova	Rr. Luigj Gurakuqi 39, Gjakovë	Veprorë Shehu
34	Mundësia	Rr. Vëllezërit Dragaj, Nr. 4, Mitrovicë	Hasime Tahiri Hasani

47	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT)	Prishtinë	Hamijet Dedolli
48	Qendra për Mirëqenien e Gruas (QMG)	Pejë	Ardita Ramizi Bala
49	Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave	Qendra Tregtare, Nr. 42, Drenas	Kadire Tahiraj
50	Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore (QTSGJ)	Rr. Luan Haradinaj, 9/4, Prishtinë	Diamant Binaku
51	RIKOTTA	Rr. Adem Gllavica, Nr. 48, Prishtinë	Pranvera Bullaku
52	RONA	Rr. Ilaz Agushi, Prishtinë	Serbeze Sylejmani
53	Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës (RROGRAEK)	Rr. UÇK, Banesa Nr. 1, Prishtinë	Shpresa Agushi
54	Ruka + Ruci	Ugljare, Fushë Kosovë	Nevenka Rikallo
55	Shoqata Afariste e Gruas SHE-ERA	Rr. Qemajli, Nr.9, Qarshia e Jupave, Gjakovë	Mirlinda Kusari Purrini
56	Shoqata e Avokatëve NORMA	Rr. Afrim Vitija, Nr. 3/ I, Prishtinë	Valbona Salihu
57	Shoqata e Femrave me Aftësi të Kufizuara “Femrat për Femra”	Rr. Zahir Pajaziti, Pn, Prizren	Drita Vukshinaj
58	Shoqata e Femrave të Shurdhëra (SHFSH)	Rr. William Volker, Nr.53	Krenare Hajredini

74	Venera	Rr. Shpëtim Bojku, Nr. 1, Pejë	Miradije Gashi
75	Violetë	Barilevë, Prishtinë	Bedrije Shala Pireva
76	Vita – Jeta	Rr. Lidhja e Prizrenit, Nr. 132, Prishtinë	Ajshe Nuhiu
77	Vullneti i Grave	Rr. 2 Maji, Studime, Vushtrri	Lirije Haziri

Anëtarët Individual të RrGGK-së

Ana Jara Gómez
Arber Sylejmani
Elisabeth Kaestli
Hajrulla Çeku
Hana Marku
Igballe Rogova

Itziar Mujika
Krenar Basha
Lepa Mladjenovic
Mimoza Pachuku
Nicole Farnsworth





Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi, C-2 II/8

10000 Prishtinë, Kosovë

+381 (0) 38 245 850

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

Facebook: [Kosova Women's Network](#)

Printim ekologjik

